




ALUMNI JOURNAL

SUCCEED WITH QUALITY

KORRIK 2013



Përmbajtja

Dymbëdhjetë	3
UBT me kampus të ri universitar	4
E suksesshme në UBT, e suksesshme në Universitetin Rutgers në ShBA	6
Shala: UBT është një vend ku krijohen vlera	6
UBT me institut të veçantë, unik dhe të vetmin në Republikën e Kosovës	7
Studentët e UBT-së punojnë dhe studiojnë në Universitetin Lawrence Technological në SHBA	8
UBT e ka anëtarësuar Republikën e Kosovës në EUROSIM	8
Abdyli: Studimet në UBT më kanë përgatitur për biznes dhe punë të suksesshme	9
Bucaliu punon në kompaninë "Gama Electronics"	9
Nga UBT-ja dalin ekspertë të Mekatronikës në Kosovë	10
Pllana: UBT i plotëson të gjitha kriteret	11
UBT e ngriti në pozitë	12
Sahiti: Në UBT e kam përvetësuar dijen akademike	12
Egzontina: edhe me pajtimin e familjes vendosa të studioja në UBT!	13
Masterin e përfundoi në Angli dhe kthehet si ekspert!	13
Cilësia e studimeve e bën UBT-në të veçanet në lëmin e IT-së	14
Yllka: UBT me program studimi të veçanta	14
Studenti i UBT-së punësohet në Angli dhe menaxhon 76 punëtorë	15
Kosumi: UBT mi hapi dyert e suksesit dhe të ligjërit	15
Arlinda, Leana dhe Armendi staf akademik në UBT	16
Nga UBT doktoratë jashtë vendit	17
Ardiana Qorraj: UBT - Universitet i mundësive të mëdha	18
Studenti i UBT-së, pas diplomimit mban dy vende pune	19
Studentët kosovar mund të vazhdojnë studimet në Universitetin e Varshavës	19
UBT lidh marrëveshje me TU Clausthal dhe Universitetin e Freiburgut	20
Tahiri nga UBT menaxher në PTK	21
Arta: Jam kthyer në Kosovë t'i kontribuoj vendit tim	22
U nënshkrua marrëveshja me Universitetin "Mimar Sinan" në Stamboll	22
Në UBT kemi gjetur një ambient për të ndjekur studimet pa shqetësim nga puna	23
Prof. Matyas ka ligjëruar në UBT	23
Mirëllinda: Në UBT dhe në Teb-Bankë!	24
Lauriku, studimet themelore i ka përfunduar në TU në Vjenë kurse ato të Masterit në UBT	24
Merita: E ardhmja e studentëve të UBT është e sigurt dhe e pakontestueshme	25
Mimoza: UBT mundësia e vetme në Kosovë	26
Suka: Menaxher i financave në kompaninë "DEMI"	26
Visar Kastrati fiton bursë në Universitetin e Sheffield	26
Petriti ligjëron në UBT	27
Prof. dr. Peter Kopaček diskutoi me studentët e UBT-së	27
UBT ka sjellë robotët e gjeneratës së fundit të NAO-së në Republikën e Kosovës	28
Dr. Beqaj: Libri do t'ju shërbejë studentëve dhe ekspertëve	29
UBT në qendër të zhvillimeve shkencore	30
Studenti i UBT-ës, qasje në Universitete amerikane	30

IMPRESUM

Alumni - Journal

Botues: Edmond Hajrizi

Kryeredaktore: Naile Demiri

Adresa: www.ubt-uni.net

Tel: 038 541 400, 044 541 400

Thyerja Grafike: ELV Studio

Shtypet në Shtypshkronjën «Roto Print»



UNIVERSITY EDUCATION
FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY

AMERICAN EUROPEAN UNIVERSITY

Editorial



Edmond Hajrizi
President i UBT-së

Dymbëdhjetë

Dymbëdhjetë vjet më parë, kur nisëm rrugëtimin tonë, e kishim të qartë çka duam, si dhe ku duam të mbërrijmë. Tash, është e lehtë të numërohen të arriturat – vetëm përmendim emrat, ngritjen shkencore e akademike dhe pozitat prestigjioze që kanë sot qindra ish-studentë tanë. Gjithashtu, kur i shohim sfidat që kemi kapërcyer, dalin se ishin shumë. Dhe, jemi krenarë se i kemi kapërcyer ato, shumë thjesht – sepse kishim të qartë synimin, të qartë e kishim edhe rrugën që duhet ndjekur për të krijuar një institucion prestigjioz si UBT-ja, që na bën krenarë ne dhe të gjithë ata që ishin dhe që janë pjesë e tij.

Këto ditë u zhvillua Ceremonia e Diplomimit 2013. Në të studimet bachelor dhe master i përmbyllën 212 studentë të Departamentit për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Departamentit për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, si dhe Departamentit për Mekatronikë.

Numrit të studentëve të diplomuar në UBT ia shtuam edhe këta 212, që hyjnë fuqishëm në konkurrencën e më të mirëve, hyjnë në garën për të qenë liderë profesionalë, që është një kërkesë e përditshme kudo në botë, por edhe në Kosovë.

E themi me këtë rast se ne po kërkojmë të zhvillojmë një personalitet, i cili është shumë i përgatitur profesionalisht, është i përkushtuar në punë, ka shkallë të lartë kreativiteti dhe inovacioni, ndërton partneritete me të tjerët, ndihmon veten dhe shoqërinë, puna e tij bazohet në fakte dhe rezultate, ka një aftësi të lartë ndërkulturore dhe interdisiplinare, por ka edhe një komunikim modern, të bazuar në vlerat më të larta.

Studimet në UBT kanë pasur dhe kanë pikërisht një qëllim: ofrimin e veglave dhe aftësive të nevojshme indi-

vidit, për të marrë vendime racionale dhe që i garantojnë atij suksese dhe vlera që bazohen në standardet më të larta evropiane dhe ndërkombëtare.

Detyra kryesore është që t'ia ofrojmë studentit tonë të gjitha arritjet e fundit në shkencën e menaxhimit, në ekselencën biznesore, në teknologjinë më moderne, në robotikë, në arkitekturë, në dizajn, planifikim hapësinor, marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci, në integrimet evropiane, por edhe në kompetencën sociale.

Kjo është mundësuar falë një planprogrami modern që UBT e ka krijuar, duke u bazuar në standardet evropiane dhe amerikane të studimeve, por edhe në bazë të nevojave dhe kërkesave që dalin nga tregu i punës.

Po ashtu, kjo është mundësuar edhe falë angazhimit të një stafi akademik me një eksperiencë të lartë ndërkombëtare në shkencë por edhe në aspektin profesional.

Më shumë se 300 profesorë dhe ekspertë, nga katër kontinente, nga 20 vende dhe kultura të ndryshme, nga rreth 100 e më shumë universitete dhe institucione partnere me renome botërore, po sjellin në UBT përvojën dhe dijen e tyre në këto programe. Kjo ka krijuar një ambient unik ndërkombëtar, ndërkulturor dhe interdisiplinar jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Kjo i krijon UBT-së mundësinë të ofrojë programe dhe projekte që nuk kanë qenë më parë të pranishme në Kosovë.

Me ceremoninë e diplomimit, ne përmbyllëm një cikël, për të hapur menjëherë ciklin tjetër, për t'u rreshtuar në fillimin e garës për të arritura dhe suksese të reja. Tash, edhe me drejtime të reja, që janë sfida për ne të gjithë.

Përkushtimi ynë mbetet i njëjtë – ju keni zgjedhur më të mirin dhe, gjithsesi, do të bëheni më të mirët. Ne e dimë saktë dhe Ju do të bindeni se UBT ua mundëson këtë.

UBT me kampus të ri universitar

Prishtinë 6 dhjetor 2012- Në magjistralen Prishtinë-Shkup, 8 km larg Prishtinës, është përruar objekti i ri i UBT-së, objekt ky i cili u cilësua si i rëndësishëm së veçantë dhe me një koncept të ri për zhvillimin e sistemit universitar e shkencor. Shiritin inaugurues, para shumë të pranishmëve, e kanë prerë Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prof. Dr. Ramë Buja dhe kryetari i Lipjanit, Shukri Buja

Duke folur para të pranishmëve, si përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të atyre ndërkombëtare, përfaqësues të medieve, profesorë dhe studentë të UBT-së dhe të ftuar të tjerë, përveç se ju shprehu mirëseardhje në ceremoninë e përrimit të objektit universitar, Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi tha se ky objekt i dedikohet 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, u dedikohet studentëve dhe familjarëve, si dhe gjithë qytetarëve të Komunës së Lipjanit. Po ashtu, studentëve u ka uruar studime të mbara.

“Pas themelimit të UBT-së në vitin 2001, dhe festimit të 10-vjetorit të punës së suksesshme të këtij institucioni, vlerësojmë se përrimi i kampusit të ri universitar shënon ngjarjen më të veçantë në historikun e këtij institucioni të arsimit të lartë, i cili shënon një fillim tjetër të funksionimit të jetës akademike dhe zhvillimit të procesit mësimor-shkencor”, tha dr. Hajrizi.

Ai më tej premtoi se përrmes kësaj infrastrukture do të ngriten kapacitete hulumtuese dhe profesionale, cilësi në shkencë, konsulencë, trajnime e certifikime, transere të teknologjisë dhe ndërkombëtarizim...

“Kjo infrastrukturë tash mundëson sfida të shumta që ka zhvillimi i vendit. Përrmes kësaj infrastrukture dhe përrmes kompetencës profesionale ne tash e tutje do t'i përrgjigjemi sfidës së prodhimtarisë vendore, përrmes kësaj infrastrukture - labororit të mektronikës dhe robotikës dhe teknologjisë së avancuar ne do ta rrisim prodhimtarinë vendore dhe do ta ulim importin dhe do ta rritim eksportin. Në fakt, përrmes kësaj teknologjie ne do t'i përrgjigjemi sfidave të teknologjisë së informacionit dhe kompetencës profesionale dhe do të kemi punësim më të madh, do të ndërtojmë biznese të qëndrueshme përr një shfrytëzim më të mirë të resurseve natyrore, do të organizojmë ngjarje të

mëdha shkencore, profesionale”, vijoi ai.

“I jemi mirënjohës Komunës së Lipjanit përr zemërgjerësinë që ka treguar me dhënien e pronës komunale përr ndërtim universiteti, ndërsa shpresojmë të jemi partnerë të mirë përr ta drejt zhvillimit të ekselencës, në edukimin e lartë, të inovacioneve dhe të teknologjisë”, tha Dr. Hajrizi në fjalën e tij, ndërsa ka shtuar se Lipjani me këtë rast iu shkëput një pjesë e tokës së pëlleshme, por nga ana tjetër fitoi ndërtimin e vendit të dijes dhe të shkencës profesionale.

UBT e bën Lipjanin qytet universitar

Ndërsa, ministri i arsimit, Ramë Buja, ka deklaruar se UBT-ja është një institucion kredibil që ka dhënë kontribut të çmueshëm, e gjithësi edhe të dalluar drejt avancimit të dijes.

“Ky universitet ia mori Lipjanit tokën e pëlleshme, mirëpo, arsyetimi më i mirë përr këtë marrje toke është të krijohet atë që është më i pëlleshmi i të pëlleshmëve, të krijohet njeriu i ditur përr Kosovën dhe këtë e besoj me sigurinë time se ky institucion do ta bëjë”, ka thënë ministri Buja.

“Këtu, në këtë vend shpresohet të studiojnë djem e vajza nga të gjitha trojet shqiptare, sepse patriotizëm kulmor tash përr tash në këtë kohë është vetëm dija”, vijoi ai.

Përr ngritjen e UBT-së, ndërkaq, Komuna e Lipjanit pati ndarë rreth 3 hektarë tokë të pronës komunale, e cila ndodhet në zonën ekonomike dhe ku tashmë ka edhe lidhje të mëdha biznesi.

Z. Shukri Buja, kryetar i Lipjanit, e pranon se në fillim kur është dhënë kjo tokë ka pasur dyshimet e veta përr ndërtim kaq të shpejtë të universitetit në fjalë.

“Kur lindi ideja përr këtë universitet ishin bukur skeptikë, madje edhe kur e dhamë pronën komunale përr këtë ndërtim, mirëpo presidenti i UBT-së, Hajrizi, e arriti këtë sukses, duke përruar objektin ndër më të mirët në këtë komunë. Personalisht sot jam tepër i privilegjuar, sepse pos përrimit të këtij universiteti po e shpalli edhe një premtim elektoral të realizuar, qytetin e Lipjanit, qytet universitar”, ka thënë Buja.

Në ngritjen e UBT-së në Lipjan, ndërkaq, është thënë se janë investuar rreth një milion euro në fazën e parë të këtij projekti. UBT-ja tashmë në brendinë e vetë ka salla laboratorësh, amfiteatrin, por edhe 15 salla mësimi me hapësirë prej 3 mijë metrash katrorë.

Kurse zëvendës-presidenti i UBT, Prof. Dr. Mo Vaziri





tha se përpjekjet tona do të bazohen në anët e forta dhe vlerat karakteristike të Kosovës.

Misioni ynë është për të ndryshuar Kosovën nëpërmjet hulumtimeve të cilësisë së lartë, kërkime studimore dhe ripërsëritje të vazhdueshme. Ne do të edukojmë ekspertë të përgjegjshëm, mendje hapur për të vepruar si largpamës të ardhshëm në shoqërinë tonë. Ne do të përdorim profilet tona unike për të stimuluar risitë dhe tejkaluar kufijtë tradicionalë. Do të ndërtojmë një komunitet të hapur për studentët, ekspertët, akademikët dhe të tjerët për shkëmbimin e lirë të ideve që ndikojnë në shoqërinë në përgjithësi. UBT do të punojë për t'u siguruar udhëheqësve akademikë procese, mjete, mbështetje dhe trajnim të duhur menaxhimi. Krahas arritjeve akademike, lidhshipi i mirë duhet të njihet dhe të shpërblehet, përfundoi ai.

UBT ndau çmim për kryetarin Buja,

Kryetarin Shukri Buja, për kontributin e jashtëzakonshëm që ka dhënë rreth objektit të ri të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe Këshilli Akademik i UBT-së, si shenjë respekti e nderuan me Çmimin më të lartë që parashihet Statuti i Universitetit UBT, "Leadership Excellence Award".

Në vijim të manifestimit, studentja Pajtesa Gashi ka thënë se ata si studentë ndihen të privilegjuar t'i vijojnë

mësimet në këtë objekt.

"Ne si studentë jemi të privilegjuar që kemi fatin të vijmë në këtë objekt kaq të bukur, të ri dhe madhështor. Gjithmonë kjo është meritë e juaja, andaj gjithmonë, duhet falënderuar juve", ka pohuar Gashi.

Më 28 tetor 2009, në Kuvendin Komunal të Lipjanit, që nënshkruar kontrata midis Kuvendit Komunal të Lipjanit dhe të UBT-së për lokacion e ri, afër QMI-së, për ndërtimin e kampusit të ri të UBT-së. Kontratën e patën nënshkruan Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe kryetari i Kuvendit Komunal të Lipjanit, zotëri Shukri Buja.

Gjatë nënshkrimit të marrëveshjes i pari komunes së Lipjanit, z. Buja, patë thënë se "Dr. Edmond Hajrizi është qytetar i komunës së Lipjanit, i cili na ka nderuar me investimin e tij në komunën tonë, me ndërtimin e objektit të Universitetit për Biznes dhe Teknologji".

Ndërsa, rektori i UBT-së, Dr. Edmond Hajrizi, ka falënderuar kryetarin Buja dhe komunën e Lipjanit, për bashkëpunimin dhe mundësinë e ofruar UBT-së, për zhvillimin dhe rritjen e mëtejme të tij.

E suksesshme në UBT, e suksesshme në Universitetin Rutgers në ShBA

Rrezarta Veseli, në vitin 2009 ka përfunduar studimet Bachelor në Fakultetin e Shkencave Politike në UBT. Ende pa përfunduar studimet, ajo përzgjidhet si finaliste në grupin e tetë studenteve nga Kosova për studime dyvjeçare Master në SHBA me bursë nga Kosova American Education Fond (KAEF), dhe vijon studimet Master në shkollën Edward J. Bloustein për Planifikim dhe Politika Publike në Universitetin Rutgers, në kampusin e New Brunswick, New Jersey.

Punimi i diplomës ka qenë i mentoruar nga këshilltarja e saj akademike, Dr. Julia Rubin. Pas diplomimit fillon punën në New Jersey Community Capital, një institucion financiar me bazë në kryeqytetin e New Jersey, ku është përgjegjëse për koordinimin e vlerësimit të projekteve.

Jashtë sferës akademike, Rrezarta ka kryer praktikën në zyrat globale të UNICEF-it në New-York. Ajo po ashtu ka qenë anëtare aktive në Shoqatën e Studentëve të nivelit Master në Universitetin Rutgers, ku ka pasur rastin të lobojë në Senat dhe Shtëpi të Përfaqësuesve për ngritjen e buxhetit federal për hulumtime shkencore dhe sociale në nivel universitar.

Në fund të vitit 2012, Rrezarta u kthye në Kosovë dhe filloi aplikimin e njohurive dhe shkathtësive të fituara



gjatë studimeve dhe përvojës së punës në SHBA. Ajo është angazhuar në disa hulumtime të politikave sociale dhe shfrytëzimin e rezultateve për të informuar alokimin adekuat të buxhetit, si dhe zhvillimin e politikave që promovojnë aktivitetet e shtuar ekonomik dhe përkrahje për edukim dhe trajnim të vazhdueshëm të punëkërkuësve.

Shala: UBT është një vend ku krijohen vlera



“Përzgjidhja ime sa i përket studimeve në Universitetin UBT ka qenë e qëlluar dhe këtë institucion ua sugjeroj të gjithëve, të cilët kërkojnë vlera, kualitet, profesionalizëm dhe ndërtimin e një karrierë të suksesshme”, tha Besim Shala, i cili studimet themelore i ka përfunduar në UBT, në Departamentin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri dhe menjëherë nisi

Masterin po në të njëjtin drejtim dhe institucion.

Ai shton se për vazhdimin e studimeve universitare, shumë njerëz ia patën sugjeruar UBT- në, prandaj ashtu edhe veproi. “Kur u regjistрова pritshmërinë e mia për këtë fakultet kanë qenë jashtëzakonisht të larta, por

ç’është e vërteta unë kam marrë nga ky fakultet shumë më tepër sesa që kam pritur”.

Shala gjatë studimeve në UBT ka hasë në përvoja të mira, duke pasur rastin të njoftohet me ligjëruesit profesionistë vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët me përkushtimin dhe punën e tyre të palodhshme e kanë nxitur të punojë edhe më tepër në mënyrë që të arrijë rezultate sa më të mira.

Shala: asistent ligjërues në UBT

“Se sa e çmoj këtë institucion tregon edhe vetë fakti se unë me përfundim të studimeve themelore menjëherë e kam vazhduar edhe karrierën si asistent ligjërues i lëndës së Matematikës, dhe në të njëjtë kohë i kam kamë vazhduar studimet posdiplomike”, thotë z.Shala, duke shtuar se UBT është një vend në të cilin krijohen vlera.





UBT me institut të veçantë, unik dhe të vetmin në Republikën e Kosovës

Prishtinë 4 prill 2013- Në UBT u bë përirimi i Institutit të Gjuhëve të Huaja dhe të Komunikimit Ndërkulturor. Fjalimin inauguroes, para shumë të pranishmeve, e ka mbajtur Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, dhe më pas drejtori i këtij Institucioni, prof. dr. Abdullah Karjagdiu. Ky institut u cilësua si i rëndësishë së veçantë dhe me një koncept të ri, si një urë bashkëpunimi në rajon dhe botë, dhe për t'i ndihmuar vendit tonë që të integrohet sa më parë në strukturat euroatlantike.

Duke folur para të pranishmëve, si përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të atyre ndërkombëtare, përfaqësues të medieeve, profesorë dhe studentë të UBT-së, dhe të ftuarve të tjerë, Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi tha se "UBT-ja është një universitet modern dhe inovativ në Republikën e Kosovë, që i ka përparësitë e universiteteve të njohura ndërkombëtare, ngase jo vetëm që ofron programe të një cilësie të lartë studimesh, por tash e tutje e ka edhe Institutin e Gjuhëve të Huaja dhe Komunikimit Ndërkulturor si për ngritjen e cilësisë së studimeve në UBT ashtu edhe për t'i ndihmuar vendit tonë që të integrohet sa më parë në strukturat euro-atlantike".

Dr. Hajrizi më tej shtoi se është institucioni i veçantë, unik dhe i vetmi në Republikën e Kosovës i këtij lloji,

ngase qëllimi kryesor i institutit është që t'i përgatisë të gjithë të punësuarit në sektorin publik dhe privat, në Republikën e Kosovës si, shërbyesit civilë të të gjitha llojeve, niveleve dhe institucioneve, pedagogët e të gjitha niveleve, arsimtarët, mjekët, politikanët, diplomatët, policët, ushtarakët, gjykatësit, etj, në zhvillimin, ngritjen, perfeksionimin dhe avancimin e aftësive dhe shkathtësive të komunikimit me shkrim dhe me gojë në gjuhën angleze dhe në gjuhë të tjera evropiane",

Ndërsa, Drejtori i këtij instituti, prof. dr. Abdullah Karjagdiu, ka deklaruar se Instituti do t'ju bëjë të mundur të gjithë të punësuarve në sektorin publik dhe privat në Kosovë që të komunikojnë, me shkrim dhe me gojë, në gjuhën angleze dhe në gjuhë të tjera botërore, me kolegët e tyre në Evropë dhe në botë, në nivel profesional, serioz dhe dinjitoz. Kjo pastaj do të bëjë të mundur ngritjen e përsheptuar dhe të sigurt të kapaciteteve të administratës shtetërore dhe të gjitha institucioneve publike dhe private vendore në përgjithësi për të qenë në gjendje që të kontribuojnë në përsheptimin e integritimeve në strukturat euro-atlantike. Garant për këtë do të jetë stafet i përgatitur dhe i motivuar i pedagogëve, profesorëve dhe asistentëve universitarë më të mirë nga vendi, rajoni, Evropa dhe ShBA-ja. Po ashtu një fjalë përshëndetëse e mbajti edhe zëvendës-presidenti i UBT, prof. dr. Mo Vaziri.



Studentët e UBT-së punojnë dhe studiojnë në Universitetin Lawrence Technological në SHBA



Njomëza Krasniqi dhe Enis Pakashtica studimet themelore i kanë përfunduar në Departamentin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinore në UBT, dhe atë në gjuhën angleze, kurse studimet Mastër i vazhduan në Tiranë, në po të njëjtin drejtim. Ata vazhduan më tutje në Universitetin Lawrence Technological- Departamenti Dizajn Parametrik Arkitektonik, në Michigan, në Shtete e Bashkuara të Amerikës, ku dhe janë në përfundim të temës së diplomës së Masterit.

“Në kohën kur kemi studiuar ne, UBT ka qenë një nga universitetet e rralla që ka ofruar arkitekturë, dhe mënyra e studimeve ishte ndryshe nga sistemi i Ballkanik si, duke na ofruar staf akademik me kualifikime të larta akademike- shkencore dhe njëkohësisht përvojë të madhe profesionale ndërkombëtare”, tha Njomëza për revistën “UBT Alumni”.

Që të dy kanë kujtime të mira për mësimdhënësit e tyre ndërkombëtarë. “Puna në UBT me profesorë kryesisht austriakë ka qenë një ndër eksperiencat më të mira gjatë studimeve, duke mos harruar asnjëherë gatish-

mërinë e tyre për të na dalë në ndihmë në çdo moment, si dhe raportin e afërt profesor-student dhe anasjelltas, që njëkohësisht e bëjnë edhe më të veçantë UBT-në, dhe ne sot ndihemi me fat që kemi pasur rastin të përfitojmë njohuri nga profesorë të tillë”, thanë ata.

Njomëza gjatë bisedës përmend edhe vizitat e organizuara nga UBT, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, duke pasur mundësinë që t’i shohim se si funksionojnë studiot apo edhe kompanitë e tjera të arkitekturës, por njëkohësisht dhe universitetet evropiane, si ai i TU Viennes, po ashtu duke mos harruar edhe punën praktike të ofruar nga UBT në kompanitë vendore, të cilat na kanë mundësuar të shohim konkretisht zbatimin e planeve dhe në përgjithësi funksionimin e tyre në Kosovë.

Paralelisht studimeve, ata janë duke punuar në studion e arkitekturës “makeLAB”, studio e cila funksioni brenda Universitetin Lawrence Technological. Së fundi kanë pasur fatin të marrim pjesë edhe në konkursin ndërkombëtarë “Flint” dhe për xhaminë qendrore në Prishtinë.

Njomëza dhe Enisi, para se të vendosin që të shkojnë në SHBA, hapën edhe një ndërmarrje dhe sollën në tregun e Prishtinës një biznes kreativ, i cili ka lidhshmëri edhe me profesionin e tyre pasi që “X edition” merret me dizajnimin, modifikimin dhe riparimin e hapësirave të brendshme të automjeteve. Kjo kompani u themelua edhe me ndihmën e Komisionit Evropian.

Njomëza shkollën fillore e ka përfunduar në vendlindje në Pejë, kurse atë të mesme në Sarajevë, po ashtu edhe Enisi shkollën fillore e përfundoi në vendlindje në Prishtinë, kurse të mesmen në Kolegjin “Mehmet Akif”.

UBT e ka anëtarësuar Republikën e Kosovës në EUROSIM

Prishtinë, 20 maj 2013 – Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, gjatë qëndrimit të tij njëjavorë në Vjenë të Austrisë, ka marrë pjesë edhe në takimin vjetor të Bordit të Federatës Evropiane e Asociacionit të Simulimeve (EUROSIM), e cila merret me modelim dhe simulim.

Në këtë takim, Bordi i EUROSIM, njëzëri ka aprovuar aplikacionin për t’u bërë Republika e Kosovës anëtare e kësaj Federate, përmes UBT- së.

Duke qenë pjesëmarrës në Këshil-

lin vjetor të EUROSIM, Presidenti i UBT-së, dr. Hajrizi ka prezantuar punën e UBT-së, konferencat dhe takimet e tjera me karakter ndërkombëtar që ka organizuar UBT, me mjaft sukses dhe duke mbledhur në Prishtinë emra të shquar të shkencës dhe ekspertë nga e gjithë bota.

Sipas tij, pas anëtarësimit në organizatën EUROSIM, hapet një dritare për komunitetin akademik të UBT-së, të cilët mund të marrin pjesë në konferencat shkencore që organizon EUROSIM, dhe në forume të tjera ndërkombëtare.



Abdyli: Studimet në UBT më kanë përgatitur për biznes dhe punë të suksesshme



“Ju sugjeroj maturantëve të vendit dhe më gjerë, që të ndjekin studimet në UBT, sepse studimet në këtë universitet janë bashkëkohore, dhe gjithçka që zhvillohet në këtë universitet është më afër arenave ndërkombëtare”, tha Flamur Abdyli, për revistën “UBT Alumni”.

Ndërlidhja në mes teknologjisë informative dhe menaxhim-biznesit, si dhe kurrikula e punuar mes asaj evropiane- amerikane, profesorët nga shtetet e Bashkimit Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mundësia e shprehjes dhe komunikimit me profesorë të cilët kishin eksperiencë ndërkombëtare, etj etj,... më bëri të filloj dhe të përfundoj me sukses të lartë studimet në UBT, të cilat studime më kanë përgatitur që të jem më afër kritereve dhe stan-

darveve ndërkombëtare për të bërë biznes dhe punë të suksesshme.

Flamur Abdyli, përveç studimeve në UBT, për Menaxhim, Biznes dhe Ekonomi, në gjuhën angleze, ka përfunduar edhe trajnimin njëvjeçar në CCNA, dhe është certifikuar për menaxhimin e rrjetave kompjuterike. Pas këtij certifikimi filloi të punojë në “Infotrade” me seli në Prishtinë për tre vite me radhë.

Kurse me përfundimin e studimeve në UBT, në vitin 2008 punësohet në bankën më të madhe në vend dhe e më tej në ProCredit Bank, në pozitën Zyrtar për Sigurinë e Informacionit, mirëpo më shumë se tre vite ka punuar edhe si Analist i Proceseve të Bankës.

Po ashtu, z. Abdyli i ka përfunduar edhe studimet Master në Universitetin e Lubjanës, në degën Banka and Fiancial Management.

Bucaliu punon në kompaninë “Gama Electronics”

Pothuajse të gjithë studentët e UBT-së, pas diplomimit, zhvillojnë karrierë të suksesshme në pozita të larta menaxhuese dhe jo vetëm në kompani dhe institucione publike por edhe në ato private, ku shumë prej tyre menaxhojnë edhe biznese të trashëguar nga familja. Donika Bucaliu, tash dhe para diplomimit ka qenë duke punuar në kompaninë gjigante familjare “Gama Electronics” në sektorin e financave, por karriera e saj është duke u zhvilluar çdo ditë e më shumë si nga ana praktike ashtu edhe ana teorike, duke i aplikuar njohuritë e fituara gjatë studimeve Bachelor në UBT, në Departamentin Bussines Management në gjuhën angleze, Ajo është duke vazhduar edhe studimet Master, po ashtu në UBT.

Donika zgjedh fjalët më të mira për udhëheqjen e UBT-së. “UBT është themeluar nga një njeri që vendi duhet të mburret me emrin dhe zotësinë e tij. Qëllimi i Dr. Hajrizit ishte që të sjellë kuadro të suksesshme në mësimdhënie në UBT dhe jam shumë e kënaqur me ato çka kam mësuar dhe rezultatet e arritura gjatë studimeve. Presidentit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizit, i uroj sukses të mëtutjeshëm, për kampusin e ri të UBT-së, i cili kampus besoj që i ka kompletuar të gjitha nevojat e studentëve dhe profesorëve që i takojnë këtij institucioni”, tha Bucaliu.

Znj. Bucaliu ka përshtypje shumë pozitive për ish-profesorët - ligjëruesit që i ka pasur gjatë studimeve themelore në UBT. Krahas organizimit të punës, seriozitetit të stafit të UBT-së, ajo veçon ligjëratat e mbajtura nga profesorëve ndërkombëtarë, “të cilët e kanë bërë të pamundurën që ne të kuptojmë gjithçka rreth lëndëve, të jemi të aftë me njërin- tjetrin, të bashkëpunojmë dhe të prezantojmë punimet e tona pa kurrfarë hezitimi”.

“Profesorë e huaj, para neve ishin njerëz më me shumë njohuri dhe të thjeshtë. Ata ishin në gjendje të ligjëronin një gjë të vetme gjatë gjithë ditës, vetëm e vetëm



që studentët të kuptojnë gjithçka lidhur me lëndën”, tha ajo.

Donika Bucaliu vjen nga qyteti i Ferizajt. Shkollën e mesme e ka përfunduar në ASK në Prishtinë.

Nga UBT-ja dalin ekspertë të Mekatronikës në Kosovë



“Njohuritë e fituara gjatë studimeve në UBT, në Departamentin e Mekatronikës, më kanë shërbyer shumë në punë, pasi të gjitha punët që i kryej në fabrikë dhe makinën të cilën e kam ndërtuar, janë të ndërlidhura me literaturën dhe me praktikën, të cilën e kemi bërë dhe fituar gjatë studimeve”, ka thënë Bardhi Zeka për “UBT Alumni”

Veprim Mustafa

Mekatronika filloi që të zbatohet qysh në shekullin e kaluar në vendet më të zhvilluar në botë. Tash kjo lëmi thuhet ka përfshijë cep më cep tërë rruzullin tokësor. Kjo lëmi para tre viteve dhe për herë të parë ka nisë të zhvillohet edhe në shtetin më të ri në Evropë, në Republikën e Kosovës e më konkretisht në Universitetin UBT.

Në fund të këtij viti akademik, katër studentë (studimet themelore: Kreshnik Ismajli, Bardhi Zeka, Granit Ramadani dhe master: Luan Mulaku) kanë diplomuar me nota të mira dhe në afat të rregullt.

“Mekatronika është çelës i zhvillimit të teknologjisë, është ndihmesë për ndërmarrjet prodhuese si private ashtu dhe publike, është ndihmesë për lehtësimin e punës për menaxherët e kompanive”, ka thënë presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i cili ishte edhe mentor i temës së diplomës, të kandidatit Granit Ramadani, i cili diplomoi me temën “Menaxhimi i procesit të prodhimit në Fabrikën “Xella Kosova L.L.C.”.



Ndërkaq i diplomuari Ramadani ka bërë me dije se pjesën praktike e ka realizuar në fabrikën “Xella Kosova L.L.C.”. “Aty kam analizuar procesin e prodhimit si dhe ia kam propozuar kompanisë tri ndryshime, të cilat do ta përmirësonin efikasitetin e procesit të prodhimit si: ndërtimi i një reaktori të ri, automatizimin e procesit të paketimit dhe monitorimi ‘online’ i procesit të prodhimit. Duke marrë parasysh njohuritë që i kam fituar për këtë lëmi dhe faktin që ky drejtim është i ri dhe ka mungesë të kuadrit të Mekatronikës, mendoj se ky drejtim ia vlen të zhvillohet edhe më shumë në aspektin edukativ. Besoj që ky drejtim do të duhej të mësohej edhe në të gjitha shkollat e mesme të larta teknike”, ka deklaruar Ramadani.

Ndërkaq Kreshnik Ismajli, i cili ka diplomuar me temën “Menaxhimi i dokumenteve personale nëpërmjet komponentëve mekatronike - USB-Dokument”, të Dr. Muzafë Shala, është shprehur se tema në të cilën ka diplomuar është e punuar me idenë e tij. “Me këtë ide isha edhe fitues i bursës ‘IpkoFoundation’, për vitin akademik 2011/2012. Këtë temë do ta bëjë publike edhe në konferencën ICIMER, të cilën e organizon UBT-ja gjatë muajit nëntor”, ka theksuar Ismajli.

Studentët e UBT-së ndërtojnë makina


Bardhi Zeka ka diplomuar te Dr. Muzafer Shala, me temën “Makina NTS – 02”. Ai me këtë temë e ka ndërtuar një makinë për tepih. Kjo makinë bënë stampimin e disa pjesëve në tepihët për makina të tipit BMW, dhe e cila është ndërtuar në Kosovë, me porosi të kompanisë “Race Mark Industries SA”, me bazë në Amerikë dhe me përfaqësues në Zvicër. “Unë kam bërë dizajnimin e sistemin elektronik dhe pneumatik të makinës. Kam bërë ndërtimin dhe gjithë sistemin elektronik dhe pneumatik si dhe programimin e tërë makinës”, ka thënë Zeka, i cili për momentin është duke punuar si inxhinier i Mekatronikës në kompaninë zvicerane “HDEW Schwiez AG”, e cila merret me prodhimin e pajisjeve për energji të pastër dhe me programimin e makinave CNC, programimin e PLC, dizajnimin dhe prodhimin e qarqeve elektrike dhe elektronike.

“Njohuritë e fituara gjatë studimeve në UBT, në Departamentin e Mekatronikës, më kanë shërbyer shumë në punë, pasi të gjitha punët që i kryej në fabrikë dhe makinën të cilën e kam ndërtuar, janë të ndërlidhura me literaturën dhe me praktikën, të cilën e kemi bërë dhe fituar gjatë studimeve. Kosova ka shumë nevojë për inxhinierë të Mekatronikës, pasi në jemi vend në zhvillim dhe çdo ditë e më shumë kemi nevojë për inxhinier të tillë, sepse çdo fabrikë, e cila hapet sot i ka të gjitha proceset mekatronike dhe kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme”, ka thënë Zeka, i cili ka vendosur që studimet e mëtutjeshme t’i vazhdojë në UBT dhe ta përvetësojë sa më shumë profesionin.

Kurse Luan Mulaku ka diplomuar në temën “Impact of electricity and EoL management; Special Case: Republic of Kosova, te prof. dr. Peter Kopacek.

Mekatronikën në Kosovë e sollti Universiteti UBT në bashkëpunim me Institutit për Udhëheqje dhe për Robotikë (IHRT) në Universitetin e Vjenës për Teknologji, Universitetin e Waterfordit për Teknologji (ISOL), Irlandë, me Laboratorin për Robotikë dhe Mekatronikë (LARM-UNIGAS), si dhe Universitetin e Cassinos në Itali

Prezantimi i parë i Mekatronikës në vendin tonë është bërë në hapjen solemne të Laboratorit të Mekatronikës në UBT. Aty është bërë i gjithë programi i Mekatronikës për studime trevjeçare dhe master. “Ky program u mundësua në bashkëpunimin të ngushtë midis UBT-së dhe Institutit për Udhëheqje dhe për Robotikë (IHRT) në Universitetin e Vjenës për Teknologji, Universitetin e Waterfordit për Teknologji (ISOL), Irlandë, me Laboratorin për Robotikë dhe Mekatronikë (LARM-UNIGAS), si dhe Universitetin e Cassinos në Itali. Ky projekt është zbatuar nga Komision Evropian më saktësisht nga TEMPUS. Laboratori i Mekatronikës në UBT, është i pari dhe i vetmi i këtij lloji në vende të Evropës Juglindore. Mekatronikë është një fushë e re jo vetëm në Kosovë, por shumë e rëndësishme, interdisciplinare, e cila do të ndikojë direkt në zhvillimin e ekonomisë dhe të industrisë në përgjithësi, si dhe në sigurimin dhe ngritjen e kualitetit të produkteve tona”, ishte shprehur me rastin e hapjes së këtij laboratorit, presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi.



Pllana: UBT i plotëson të gjitha kriteret

Arben Pllana thotë se ka kaluar nëpër disa faza të shkollimit dhe ka punuar në shumë kompani dhe organizata të huaja, por kontaktet që kishte me persona me renome ndërkombëtare në Norvegji dhe në Kosovë, sa ishte në punë në OSCE dhe diskutimet me ta lidhur me vazhdimin e studimeve në një Universitet që ka emër dhe cilësi, e bënë që të hulumtojë dhe të kuptojë se UBT ishte Universiteti që për të i plotëson të gjitha kriteret.

Shkollimi siç bëhet në UBT ua mundëson studentëve kosovarë që të kenë më me pak shpenzime nga një ligjërim nga profesorët eminentë nga e gjithë bota.

Z.Pllana, studimet themelore i ka përfunduar në UBT në Departamentin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, gjithashtu ka përfunduar një varg trajnimesh e kurse të shumta, po ashtu ka punuar në shumë kompani e organizata ndërkombëtare, por të fundit herë që ende e gjejmë në vazhdim në pozitën Mbikëqyrësit për krime të rënda në Regjionin e Mitrovicës.



UBT e ngriti në pozitë



“Pasi që e kam parë ofertën e ofruar nga UBT, kam menduar se oferta është ajo që më përshtatet mua, pasi që programi zhvillohet nga profesorë që kanë eksperiencë në fakultetet me renome evropiane dhe sigurisht mundësia e zgjedhjes së orarit të ligjëratave më është përshtatur”, Fatmire Mulaj, e

cila studimet themelore i ka përfunduar në Fakultetin Political, Science and Diplomacy në UBT, atë në gjuhën angleze, dhe menjëherë ka vazhduar mastarin në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi.

Ajo më tej shton se fatmirësisht në drejtimin ku ka studiuar kanë ligjëruar profesorë që kanë qenë të shpërblyer për punën e tyre edhe në universitetet me renome evropiane, njerëz me eksperiencë të ndryshme, përpos

përvojës profesionale që kanë ofruar për studentët e UBT-së, ata gjithashtu kanë ofruar edhe përkrahje tjera për studentë, si .p.sh vizitat në Universitetin e Austrisë, një mundësi e shkëmbimit të përvojave dhe njohurive.

“Gjate studimeve themelore në UBT kam pasur titullin Zyrtare e Personelit në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale pasi që kam arritur që në afat të përfundoj të gjitha provimet dhe të mbroj edhe titullin Bachelor in Law, Political Science and Diplomacy ku gjithashtu jam shpërblyer me certifikatë studente e dalluar, kanë qenë këto dëshmi që kërkesa ime për ngritje të pozitës të aprovet nga Drejtori Ekzekutiv i Institucionit. Tashmë jam Kryesuese e Sektorit të Personelit”, tha ajo.

Mulaj shton se, ka qenë një mundësi, ofrim i një mundësie po e ritheksoj me ndryshe nga eksperiencat e mia të deritashme, me një punë të vullnetshme mund të shfrytëzosh eksperiencën e UBT-së dhe realitetin që ballafaqohemi, një kombinim që të arrish të zgjedhja e problemeve me lehtë dhe në mënyra bashkëkohore.

Sahiti: Në UBT e kam përvetësuar dijen akademike



Sikurse të tjerëve, edhe Avni Sahitit, gjatë studimeve përshtypje të mëdha i kanë lënë ambienti modern i hapësirave të UBT-së, performanca e lartë e profesorëve dhe ligjëruesve, synimi i tyre që studentët t'i asimilojnë dhe t'i bëjnë pragmatike dijet e përcaktuara gjatë programit akademik dhe gjithësi aplikimi i përvojave moderne të dijeve në koherencë me universitetet më prestigjioze në botë.

“Zhvillimi i institucioneve arsimore dhe akademike në Kosovë është imperativ i kohës, por ky proces mendoj që nuk ka shkuar rrugës së duhur. Kjo vjen si pasojë se programet universitare në të shumtën e rasteve nuk i janë përgjigjur kërkesave dhe tregut bashkëkohor. Por, me themelimin e UBT-së dhe me qasjen thellësisht

profesionale që e ka bërë menaxhmenti i këtij institucioni, duke zhvilluar politika të qarta të programeve akademike, unë sikurse edhe shumë studentë të tjerë kemi vendosur që të konkurrojmë për t'i vazhduar studimet postdiplomike”, tha Avni Sahiti, për revistën “UBT Alumni”, duke shtuar se kualifikimi superior për tregun e punës sot nuk do të thotë shumë, por me programin të cilin e posedon UBT dhe me stafin profesional të saj, diplomimi dhe gradimi në UBT është hap i sigurt për tregun e punës dhe për karrierë.

Sikurse të tjerëve edhe z. Sahitit, gjatë studimeve përshtypje të mëdha i kanë lënë ambienti modern i hapësirave të UBT-së, performanca e lartë e profesorëve dhe ligjëruesve, synimi i tyre që studentët t'i asimilojnë dhe t'i bëjnë pragmatike dijet e përcaktuara gjatë programit akademik dhe gjithësi aplikimi i përvojave moderne të dijeve në koherencë me universitetet më prestigjioze në botë.

Ai më tej shton se ardhja e ekspertëve, profesorëve dhe ligjëruesve ndërkombëtarë për të ligjëruar para studentëve të UBT-së, nënkupton përvetësimin të drejtpërdrejtë të dijeve bashkëkohore nga ana e studentëve tanë. Sektori i arsimit në Kosovë kurrë nuk ka pasur më shumë nevojë për profesorë dhe ekspertë ndërkombëtarë, pasi që synimi i të gjitha politikave zhvillimore të vendit mundohen të jenë në barasvleshmëri me politikat zhvillimore të vendeve të zhvilluara. UBT-ja na ka mundësuar t'i kuptojmë dhe t'i aplikojmë dijet të cilat aplikohen nga kolegët tanë kudo nëpër vendet e zhvilluara.

Në UBT kam mësuar se secila dije njerëzore, qoftë edhe dija që zhvillohet krejtësisht mbi baza dhe premisa teorike, duhet t'i gjejë rrugët dhe shtigjet e zbatimit praktik, përndryshe dija nuk është funksionale dhe si e tillë e pavlefshme. Menaxhimi i situatave ku nevojitet efikasiteti, zgjidhje e qëndrueshme me rezultate konkrete kërkon gjithësi një përvojë akademike, të cilën fatmirësisht e kam përvetësuar gjatë studimeve në UBT.

Dinamika bashkëkohore e të gjitha punëve, sidomos atyre menaxheriale, kërkon investim, energji, durim dhe përballje me stresin e për çdoditshëm. Suksesi i përballimit të tyre dhe produkteve pozitive gjithmonë është i lidhur me një përvojë akademike, ku modelohen format e kryerjes së punëve profesionale. Në UBT unë e kam përvetësuar dijen akademike që ka ndikuar dhe ndikon në suksesin tim profesional dhe në karrierën time të mëtutjeshme profesionale dhe akademike, përfundoi Avni Sahiti, për revistën "UBT Alumni".

Avni Sahiti, temën e Masterit me titull "Menaxhimi strategjik i reformës së pushtetit lokal në Republikën e Kosovës", e ka mbrojtur në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT. Hulumtimin e tij e ka paraqitur para Prof. Dr. Ibrahim Krasniqi dhe komisionit të përbërë nga Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe Prof. Dr. Mo Vaziri.

Z. Sahiti është i punësuar në pozitën e Udhëheqësit të Departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Avni Sahiti ka lindur më 31.03.1972 në Keqekollë të Prishtinës, shkollën e mesme e ka kryer në Prishtinë, studimet themelore në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës në vitin 1997, kurse në UBT e ka kryer Masterin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në vitin 2012. Ndërkaq gjatë një dhjetëvjeçari i ka përfunduar disa specializime në institucione arsimore ndërkombëtare, si; ekspert Ndërkombëtar i Prokurimit Publik në UBT, në vitin 2007; Programi Zhvillimor për Leadership të Lartë - Universiteti i Kalgarit, Kanada në vitin 2004; Shkolla për Demokraci Lokale e Këshillit të Evropës - Strasburg, Francë në vitin 2008; Qendra Ndërkombëtare për Trajnime (International training Center – ILO, Torino – Itali në vitin 2009 e shumë trajnime të tjera.

Egzontina: edhe me pajtimin e familjes vendosa të studioja në UBT!



"Unë qysh herët isha orientuar të vazhdoja studimet për arkitekturë dhe isha në kërkim të një universiteti adekuat, që do t'i plotësonte kërkesat e mia. Për UBT-në kisha dëgjuar gjatë shkollës së mesme, si një ndër institucionet më serioze dhe bashkërisht, me pajtimin e familjes time, vendosa të studioja në UBT", tha Egzontina Shabaj, nga Peja, e cila studimet themelore i ka përfunduar në Universitetin UBT, në Departamentin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor.

Në kohën kur unë studioja, UBT ishte i vetmi universitet që ofronte studim në lëmin e arkitekturës, dhe atë të nivelit

të lartë evropian. Më pas, gjatë studimeve në UBT, pata mundësinë të njihesha me shumë profesorë vendorë dhe të huaj të nivelit të lartë akademik-shkencor, të cilët edhe ishin të gatshëm t'i ndanin njohuritë e tyre me ne, shtona Shabaj.

Gjatë studimeve po ashtu patëm edhe një varg vizitash të organizuara nga UBT, si brenda dhe jashtë vendit, ku ne patëm mundësinë t'i shohim se si funksionojnë studiot, kompanitë e tjera të arkitekturës, ndërmarrjet prodhuese të materialeve ndërtimore, po ashtu duke mos harruar edhe punën praktike në kompanitë vendore, ku kishim mundësi të shohim nga afër zbatimin e projekteve.

Menjëherë pas studimeve kam punuar si arkitekte në kompani të shumta private dhe vazhdoj të punoj. Gjatë kësaj periudhe pata mundësinë të vizitohesh shumë shtete të Evropës, duke m'u dhënë mundësia që, përveç zhvillimit profesional, të njihja shumë njerëz të kulturave të ndryshme.

Përvoja e fituar gjatë studimeve është pjesë përcjellëse e funksionimit të mirëfillt të punës dhe rritjes profesionale. Shpeshherë hasi në situata me të cilat kam qenë e njoftuar qysh gjatë studimeve, por duke shfrytëzuar njohuritë e fituara i zgjidhi me lehtësi.

Ambiciet e mia janë që të vazhdoj studimet posdiplomike në njërin nga universitetet prestigjioze evropiane. Jam në pritje të një përgjigjeje konkrete nga ata, por duke mos i lënë pas si mundësi e dytë edhe universitetet e rajonit, përfundoi Shabaj.

Masterin e përfundoi në Angli dhe kthehet si ekspert!



Berat Thaqi, posa përfundoi studimet Master në Britani të Madhe, në Universitetin Staffordshire, në programin Economics for Business Analysis, kthehet në Kosovë, dhe angazhohet në disa kompani private si ekspert i fushës që ka, kurse studimet themelore i patë përfunduar në UBT, në Departamentin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi,

"Në UBT pata vendosur të studioj për shkak të cilësisë së ligjëruesve, të cilët kanë qenë nga shtetet kryesisht nga Evropa dhe bota, dhe ligjërimi në

gjuhën angleze, do ta përmendja profesorin Kim Serota, nga SHBA, që ka pas një qasje shumë praktike të ligjëritit të lëndës "Integrated Marketing Communication", tha B. Thaqi.

Ai më tej shtonë se, puna që bëhet në UBT është për tu vlerësua e sidomos në aspektin shkencorë, për arsye: se sjellja e stafit akademik nga vende e ndryshme, sigurisht që mundësia e zgjedhjes për dije është më e mëdha dhe më kualitative, dhe aq më tepër, që në vendet e zhvilluara, edukimi dhe përvojat e atyre profesorëve janë shumë më të pasura.

UBT vazhdon të ndërtohet ndër vite dhe kjo është diçka tejet e çmueshme për vendin tonë, gjë që ky institucion ka vazhduar ta mbajë cilësinë si qëllim të vetëm, dhe për këtë e ka vendin e merituar në Republikën e Kosovës dhe më gjerë, përfundoi B. Thaqi.

Cilësia e studimeve e bën UBT-në të veçanet në lëmin e IT-së

“Përvoja e fituar, cilësia e ligjërave dhe ndihma e ofruar nga stafi gjatë studimeve Bachelor në Departamentin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieris, më kanë bërë të kthehem edhe për në studime Master në Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi”, tha Naim Preniqi, për revistën “UBT Alumni”.

Ai më tej shtoi se gjatë studimeve në UBT ka pasur eksperiencën të shumta e të e paharruar si në grupe të ndryshme studentësh me përvoja të mëdha në fushën e IT-së dhe menaxhimit, të mësuarit në grup dhe aftësimin për t’i zbatuar teoritë në praktikë etj etj, të cilat e bëjnë UBT-në të veçanet në lëmin e IT-së dhe menaxhimit të projekteve. Krahas studimeve aty ofrohen edhe certifikime të llojeve të ndryshme. Po ashtu, Naimi nuk lë pa për-

mendur edhe profesorët, me emra të njohur botërisht dhe ligjërata me cilësi.

Atij studimet Bachelor në fushën e IT-së i kanë ndihmuar shumë veçanërisht në analizimin e proceseve administrative-manuale t’i kthejnë në ato elektronike. Gjithashtu edhe studimet Master në MBE i kanë ndihmuar në aplikimin e menaxhimit të projekteve në lëmi të ndryshme. Tani punon në UBT, si staf i rregullt.

Naimi më tej shtonë se qasja ndaj problemeve ka qenë më ndryshe e fokusuar, kurse me njohuritë e fituara në UBT problemi shikohet në një spektër më i gjerë dhe më alternativ.

I gjithë stafi i UBT-së është shumë profesional dhe punojnë që të jenë sa më afër studentëve, përfundoi z. Preniqi.



Yllka: UBT me program studimi të veçantë



Yllka Osmani, e cila studimet themelore i ka përfunduar në UBT, në Departamentin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, në gjuhën angleze, për revistën “UBT Alumni”, thotë se programet e UBT-së ofrojnë studime të cilat studentit i garantojnë arritje të vlerave intelektuale dhe profesionale, po ashtu UBT ofron shkollim me cilësi të larta dhe sipas standardeve ndërkombëtare.

“Unë mendoj që kemi pasur një mundësi të veçantë në gjeneratën e parë të këtij Universiteti, ku takuam për herë të parë profesorë eminentë nga e gjithë bota. Kishim një program studimi të veçantë nga universitetet e tjera, dhe të përbashkët me universitetet më të njohura në Evropë dhe botë, që paraqiste një bazë të fortë për ne studentët dhe na mundësoi zhvillimin e aftësive dhe ideve tona”, thotë Yllka.

Mundohem që ta kryej punën në mënyrë shumë profesionale. Kjo vjen nga studimet tona si dhe nga praktika e mirë që e kemi marrë në UBT. Jam e bindur dhe kam informata se në të gjitha kompanitë ose institucionet ku janë të punësuar, studentët e UBT-së janë të përgatitur dhe të gatshëm të përballën dhe të menaxhojnë pa probleme, përfundoi Yllka.

Prej vitit 2001 znj. Yllka ka punuar në sektorin privat bankar, ku tash e gjejmë në njërin ndër bankat më të suksesshme në vend, në “Raiffeisen Bank”, në pozitën Menaxhere e Shitjes në Degën e Fushës Kosovës.

Studenti i UBT-së punësohet në Angli dhe menaxhon 76 punëtorë

Amir Asllani

Një numër i konsiderueshëm i të diplomuarve në UBT sot janë në pozita të mira udhëheqëse, duke përfshirë kompani publike dhe private, si në vendin tonë ashtu në rajon dhe në Evropë.

Njëri nga ta është edhe Ylli Latifi, i cili na rrëfen se pas përfundimit të studimeve në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Diplomacisë në UBT u transferua në Londër për punësim dhe për studime të më tutjeshme.

“Gjatë studimeve në UBT mora disa grante që të vazhdoja studimet në disa universitete angleze po ashtu edhe oferta për punësim si në Angli, Gjermani, Austri, Zvicër, Amerike e deri në Kuvajt, mirëpo, duke pasur parasysh që një pjesë të jetës e kam kaluar në Londër, po ashtu kisha banesën në këtë qytet dhe e dija gjuhën angleze, vendosa të punësohem dhe të jetoj për momentin këtu”, thotë Ylli.

Ylli tani është i punësuar në kompaninë më të madhe tregtare në Angli, Marks & Spencer” dhe ka pozitën Head Senior Manager for Costumer Relations dhe menaxhon një numër të konsiderueshëm të punëtorëve.

“Në këtë pozitë kam treguar aftësi shumë të mira me punën për klientë, si dhe shumë shpejt kam mësuar të gjitha politikat e kompanisë në të cilat marrim çdo veprim. Tani udhëheqi një sektor ku kam 76 punëtorë që i menaxhoj dhe udhëheqi departamentin më kritik të kompanisë”, thotë Ylli.

Ylli mendon që në një të afërt të vazhdojë edhe studimet postdiplomike dhe oferta të bollshme nuk mungojnë.



“Tani kam një ofertë për bursë të plotë për studime master në Greenwich Business School, po ashtu në London City University, por do të pres edhe pak kohë, që të punoj dhe të kem financa stabile. Po ashtu, planifikoj që të shkoj në London Diplomatic Academy, që është pjesë e Westminster University dhe aty të përfundoj Master në Diplomaci apo Marrëdhënie Ndërkombëtare. Po ashtu mendoj edhe studimet për doktoratë në Diplomaci dhe pastaj të vazhdoj ndoshta punën në kompaninë ku jam”.

Ai mendon të kthehet në Kosovë që të ndaj eksperiencat me studentët dhe t’ju tregoj atyre se asgjë nuk është e pamundur po të kesh vullnetin dhe e vetmja gjë që të ndalon nga suksesi është frika e dështimit.

Kompania ” Marks & Spencer” ka 1010 lokacione dhe zyre të saj në të gjitha anët e botës. Vetëm në Britani të Madhe ka 700 lokale, kurse në 40 vende tjera të botës ka 310 lokale dhe ka qarkullim vjetor prej 523 milionë.

Kosumi: UBT mi hapi dyert e suksesit dhe të ligjërimit



Ajete Kosumi, ende pa përfunduar studimet e nivelit Master në UBT, dhe falë njohurive të fituara gjatë studimeve që ka përfunduar deri më sot, ka filluar të ligjëroj lëndën “Operations managment” në platformën eTrajnimi-it, ndër platformat e para në vendin tonë, përmes trajnimeve online, përmes video-konferencave, dhe të implementuar nga kompania “Trendbiz”.

“Lënda është e bazuar për nivele të ndryshme universitare, po ashtu edhe ata të cilat janë të punësuar dhe dëshirojnë të mësojnë me shumë për rëndësinë e operacioneve në një organizate dhe dizajnimin e proceseve brenda saj”, tha znj. Kosumi për gazetën “UBT News”.

Përdoruesit e eTrajnimi-it, mund të ndjekin kurset online, të cilat janë të përshtatshme ku mundësia për studim është 24 orë 7 ditë në javë. Mund të mbahen ligjëratat prej profesorëve eminent me tituj akademik, të pranoni lajmërime, të qaseni në shënime dhe literaturë, të rishikoni detyrat, të merrni pjesë në kuize praktike, të diskutoni pyetjet, të bashkëbisedoni me studentët e tjerë dhe të studioni kur do që ju dëshironi, përfundoi ajo.

Arlinda, Leana dhe Armendi staf akademik në UBT

Një numër i studentëve të cilët kanë mbaruar studimet me sukses të shkëlqyer në UBT, dhe më pas kanë vazhduar studime jashtë vendit nëpër Universitete më prestigjioze të Bashkimit Evropian, sot janë kthyer në Kosovë, pikërisht në UBT, për të vazhduar karrierën e tyre në mësimdhënie. Arlinda Shaqiri për revistën "UBT Alumni" thotë se njohurit e fituara gjatë studimeve themelore në UBT dhe tani në Universitet Politecnico Di Milano, janë çelësi i suksesit për të ardhmen e saj, e cila pas diplomimit të studimeve të dyja niveleve kthehet në Kosovë dhe fillon e ligjëron në Fakultetin e Arkitekturës në UBT. "Jam kthyer në Kosovë t'i kontribuoj vendit tim, projektet italiane dhe njohuritë e marrura në Universitetin Politecnico Di Milano për t'i transferuar në Kosovë, për dhënie dhe për një arsimim më të mirë gjeneratave që do të vijnë, përmes ligjërimit", thotë Arlinda Shaqiri, e cila studimet bachelor i ka përfunduar me suksese në Departamentin Arkitekturë në UBT, kurse studimet Master po në të njëjtin drejtim, vetëm jashtë vendit më konkretisht në Universitetin Politecnico Di Milano në Republikën e Italisë, dhe diplomon me temën "Exploring hedonism sustainability through social housing, an experimental idea for minimizing of use in big cities. Ashtu edhe Leana Mahmuti e ndërron mendjen dhe kthehet në Kosovë, ku tash e gjejmë si asistente- ligjëruese e lëndës Konstrukione arkitektonike II, në Fakultetin Arkitekturë,

ku dhe vet në këtë fakultet i ka përfunduar studimet themelore. Kurse studimet për master jo në UBT por në Universitetin «Politecnico Di Milano» në Republikën e Italisë, drejtimi Arkitekturë, dhe diplomon me temën "Projekti urbanistik dhe arkitektonik në qytetin e Barcelona". Pas përfundimit të studimeve Leana shkon në Francë dhe menjëherë punësohet në një zyre të arkitekturës në qendër të Parisit, «Park & Asocies», dhe paralelisht punës e përvetëson gjuhën frënge në një shkollë të gjuhëve në Paris. Edhe Arment Merovcin e gjejmë si asistent-ligjëruese në Fakultetin Ekonomik në UBT, po ashtu edhe Armendi studimet themelore i ka përfunduar në këtë fakultet, e studimet Master i ka mbaruar në Finance and Investments në "Queen Mary University of London" në Londër, në Angli. Pas përfundimit të studimeve punësohet në kompaninë për shërbime financiare "Thomas Murray", në Angli. Nga 2010 e vazhdon karrierën në Kosovë në këto në pozita të ndryshme, në Ministrinë e Financave në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ku ende është aktual. "Arsyeja kryesore që më ka shtyrë të studioj në UBT ka qenë kurrikula e universitetit. Po ashtu, edhe profesorët kanë qenë shumë të mirë dhe me përgatitje të lartë profesionale dhe shkencore". Përveç këtyre treve, UBT ka edhe një numër të madh të studentëve të cilët janë duke mbaruar studimet jashtë vendit, jo vetëm Mastër por edhe studime të doktoratës, të cilët do paraqesim në numrin e gazetës në vijim.





Nga UBT doktoratë jashtë vendit

Mimoza Dugolli, Binak Beqaj, Lulzim Beqiri dhe Muhamet Ahmeti, të cilët kanë përfunduar studimet master në UBT, menjëherë kanë vazhduar studimet e doktoratës në Universitetin Teknik të Vjenës (TU), në Austri, kurse Ilir Hajdini, studimet themelore i ka përfunduar në UBT, masterin jashtë vendit në Angli, kurse të doktoratë i ka regjistruar në TU, po ashtu Ermal Lubishtani studimet themelore i ka përfunduar në UBT, kurse ato të masterit në Angli, dhe menjëherë, pa humbur kohë futet në ato të doktoratës në Angli.

Doktorët e Vjenës

Binak Beqaj me sukses të dalluar, e ka mbrojtur temën "Integrated Urban Management", te mentori Prof. Dr. Jens Dangschat, dhe mori titullin Doktor i Shkencave Teknike. Dr. Beqaj në UBT mbanë pozitën e prodekanit në Departamentin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, ku është edhe ligjërues.

Znj. Dugolli, vitin që lamë pas ka diplomuar me temën "Arkitektura Bioklimatike dhe Automatizimi i shtëpive të banimit, rast studimi: Objektet e banimit në Kosovë" te Prof. Dr. Peter Kopaçek, dhe ka fituar titullin Doktor i Shkencave Teknike. Gjatë studimit të saj është përqendruar më shumë në sektorin e shkencave socio-ekonomike. Ky hulumtim më shumë ishte i drejtuar nga proceset që janë zhvilluar në Kosovën e pasluftës, respektivisht privatizimi i Ndërmarrjeve Publike, me theks të veçantë procesi i privatizimit të Korporatës Energjetike të Kosovës, staf i së cilës kompani është edhe vetë znj. Dugolli, ku mban pozitën e menaxheres në Departamentin e Përkrahjes Afariste.

Po ashtu, Lulzim Beqiri, njëherit edhe është ligjërues në Departamentin e Arkitekturës dhe menaxher për Zyrën e projekteve në UBT, është në përfundim të këtyre studimeve, dhe brenda këtij viti pret të diplo-

mojë, te mentori, prof. dr. Peter Kopaçek. Ai temë hulumtimi e ka "Faktorët që ndikojnë në menaxhimin strategjik të ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla ndërtimore në Kosovë".

Kurse, Muhamet Ahmeti, po në këtë vit diplomon te mentor prof. dr. Peter Kopaçek, ndërsa tema e tij është "Logjistika dhe transport dhe menaxhimi i projekteve ndërtimore". Z. Ahmeti është ligjërues i rregullt në UBT në Departamentin e Arkitekturës, gjithashtu mban edhe pozitën e Drejtorit të Infrastrukturës.

Vlen të veçohet se studentët e UBT-së edhe më herët e kanë pasur këtë mundësi të lëvizin nëpër universitete më prestigjioze nëpër Evropë dhe botë. Një rast që vlen të përmendur është Ilir Hajdini, i cili studimet themelore i ka përfunduar në UBT, masterin në Angli, kurse doktoratën e ka regjistruar në TU.

Doktori i Anglisë

Ermal Lubishtani, i cili pas përfundimit të studimeve themelore në Departamentin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, dhe ato nivelit Master në Staffordshire University në Mbretërinë e Bashkuar, fiton bursë nga Open Society Foundation dhe Staffordshire University, për të vijuar me studimet e doktoratës (PhD), në Universitetin Staffordshire në Business and Laë School në drejtimin PhD in Economics. Teza e doktoratës së tij ka për qëllim të hulumtoj faktorët të cilët përcaktojnë rritjen ekonomike të një vendi me fokus të veçantë vendet në tranzicion, siç është rasti me Kosovën. z. Lubishtani, pas përfundimit të studimeve Bachelor punësohet menjëherë në UBT, në cilësinë e koordinatorit të programeve të Masterit, kurse pas përfundimit të studimeve Master angazhohet si ligjërues në disa lëndë, dhe më pas merr pozitën e prodekanit të Fakultetit Management, Business and Economics në UBT.

Ardiana Qorraj: UBT - Universitet i mundësive të mëdha

“Të studiosh në UBT është e njëjta gjë sikur të jesh pjesë e universiteteve më të njohura evropiane, për faktin se UBT ka sjellë gjithmonë profesorët më të mirë në universitetin tonë”, tha Ardiana Qorraj për revistën “UBT Alumni”



UBT Alumni: Si vendosët të studioni në UBT?

Ardiana Qorraj: Si fillim, gjatë vijimit të klasës së XIII-të kur isha në gjimnaz fillova të mendoj më seriozisht për të vazhduar studimet në arkitekturë. Fillova të bëj një hulumtim për universitetet private që në planprogramet e tyre, e kishin edhe programin e arkitekturës. Mes UBT-së dhe të tjerave dhe u përcaktova për UBT-në për disa arsye: së pari qasja e UBT-së për të pasur më pak marketing përmes TV-së siç jemi mësuar të shohim çdo ditë, dhe këtë e kuptova më vonë se UBT-të e bën marketingun më të mirë duke nxjerrë kuadrot më të mira; programi mësimor dhe metodat e mësimdhënies; stafi akademik; bursa për nxënësit e shkëlqyeshëm. Pra, këto ishin disa nga arsyet që u përcaktova që të studioj në UBT.

UBT Alumni: A mund të na rrëfeni diçka nga studimet tuaja në UBT. Çka ju ka lënë më së shumti përshtypje?

Ardiana Qorraj: Të studiuarit në UBT më ka krijuar mundësi të mëdha, si fillim njohje të reja me njerëz të profesionit tim të ardhshëm, arkitekturës. Qasja shumë profesionale ndaj studentëve, mundësia që studentët të thonë gjithmonë fjalën e tyre, e jo të jenë vetëm dëgjues të asaj që ligjërohet, metodat e ligjërimit teorik dhe të praktikuarit e asaj që na ligjërohej etj. Pjesa më e veçantë dhe më mbresëlënëse për mua kanë qenë vizitat studimore që i kemi bërë në vendin tonë dhe pjesëmarrja në ekspozitat që i organizonim çdo fundvit për të prezantuar punën tonë dhe përvojat e fituara.

UBT Alumni: UBT njihet si institucion që ka sjellë dhe vazhdon të sjellë në Kosovë profesorë eminentë nga e gjithë bota. Si e keni vlerësuar këtë fakt dhe sa konkretisht ju kanë ndihmuar ata?

Ardiana Qorraj: Të studiosh në UBT është e njëjta gjë sikur të jesh pjesë e universiteteve më të njohura evropiane, për faktin se UBT ka sjellë gjithmonë profesorët më të mirë në universitetin tonë. Unë personalisht kam pasur fatin të dëgjoj ligjërata e tre profesorëve që kanë ligjëruar dhe vazhdojnë të jenë ligjërues në universitetet më të njohura evropiane. Ata kanë qenë shumë të mirë në të kuptuarit dhe të dhënurit e njohurive tyre duke na ofruar neve praktikat dhe përvojat prej nga vinin ata. Por, njëkohësisht, qëndroj prapa mendimit tim se profesorët tanë vendorë që ligjërojnë në UBT kanë pas vetes, përveç përgatitjes profesionale, një përvojë më të kompletuar në aspekt të përballjes me proceset zhvillimore, ekonomike të një vendi të okupuar siç ka qenë vendi ynë, si dhe përvojën e periudhës së tranzicionit që po kalojmë tani.

UBT Alumni: Po kështu, UBT ofron edhe mundësinë e udhëtimeve studimore në institucione prestigjioze ndërkombëtare me të cilat ka bashkëpunim, apo edhe vizita studimore në ndërmarrje e institucione të rëndësishme në vend. Sa ju kana ndihmuar juve konkretisht këto vizita?

Ardiana Qorraj: Të praktikuarit, të prekurit dhe të vështruarit për së afërmi atë që në vazhdimësi e kemi mësuar teorikisht ka qenë gjëja më me vlerë që na ka ofruar UBT. Krahas kësaj, pastaj edhe kërkimet e mia kanë qenë më të mëdha për të gjetur sa më shumë shembuj krahasues, në mënyrë që t'i përshtatem praktikave të UBT-së, që na ofronte përmes vizitave në vendpunishte, vizitave nëpër objekte me karakteristika të veçanta që na ndihmonte shumë në të kuptuarit e asaj që studiojm.

UBT Alumni: Pas diplomimit, Ju tani po zhvillon karrierë të suksesshme. A mund të na thoni konkretisht ku jeni duke punuar, cili është pozicioni juaj dhe sa në të vërtetë keni arritur në karrierë deri tash?

Ardiana Qorraj: Gjatë studimeve në UBT, më konkretisht që nga semestri i IV-të i jam nënshtruar procesit zgjedhor për zgjedhjet lokale të mbajtura në vitin 2009, nga të cilat kam fituar mandatin e asambleistes në Kuvendin Komunal në Deçan, për mandatin tim të parë, 2010-2013. Për mua ka qenë një përvojë e re, por që më ka ndihmuar dhe kam dhënë shumë nga vetvetja duke kontribuar në fushën e urbanizmit, pasi që njëherësh jam anëtare në Komitetin e Urbanizmit të Kuvendit Komunal. Njëkohësisht gjatë studimeve kam filluar të punoj në një byro projektues “VIZION B” në Deçan, përvojë kjo që më ka profilizuar më shumë që të merrem konkretisht me Trashëgiminë Kulturore.

Gjithashtu, pas diplomimit në UBT dhe përvojës së fituar, arrita të bëhem pjesë e stafit profesional në Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, që nga tetori i vitit 2011. Dhe në mënyrë aktive punoj dhe kontribuoj në vetëdijesimin, ruajtjen e monumenteve të trashëgimisë arkitekturore në Kosovë.

UBT Alumni: Në profesionin Tuaj dhe në detyrat e përditshme të punës, takoheni me probleme e situata të ndryshme. Sa mendoni se ju ndihmon në zgjidhjen e detyrave të punës apo çështjeve të biznesit a çështjeve të ndryshme përvoja që keni fituar gjatë studimeve në UBT?

Ardiana Qorraj: Të them të drejtën më ndihmon shume përvoja e fituar në UBT, dhe pothuajse çdo ditë përballim më të njëjtat gjëra që i kam mësuar në UBT, kuptohet tani në një këndvështrim dhe përballje të problematikës së punës në mënyrë të drejtpërdrejtë. E them me një bindje të plotë se UBT na ka ofruar zgjidhjen më konkrete dhe programin më real duke na përgatitur njëkohësisht për tregun e punës.

Studenti i UBT-së, pas diplomimit mban dy vende pune



Arlind Nushi, për revistën "UBT Alumni", tha se niveli i profesionalizmit, programet e studimit dhe kualiteti i tyre, kanë qenë hap i parë për të vendosur për të studiuar në Departamentin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT. "Menjëherë pas diplomimit, por edhe gjatë studimeve, kam pasur oferta të punësimit, të cilat edhe i kam shfrytëzuar, por, më e rëndësishmja është që pas studimeve jam punësuar në agjencinë kreative "Trokit", në të cilën mbaj pozitën Udhëheqës i Departamentit të webit. Kjo është arritja më e madhe deri tani, por gjithashtu punoj edhe si "Freelancer"

dhe punoj me klientë internacionalë. Falë përvojës dhe mësimit që ka marrë gjatë studimeve në UBT, z. Nushi është në gjendje të përballet më të gjitha rastet e mundshme, por mjafton të përdorë metoda e hulumtimit të cilat i ka mësuar në UBT dhe çdo problemi i gjendet zgjidhja e shpejtë dhe në mënyrë korrekte.

"Është e domosdoshme që UBT të mbajë kualitetin e studimeve në nivelin e lartë dhe të vazhdojë të sjellë/ gjenorëj kuadro profesionale pasi që shihet si nevojë e madhe për tregun tonë si dhe atë global", tha Nushi.

Studentët kosovar mund të vazhdojnë studimet në Universitetin e Varshavës

Prishtinë, 10 qershor 2013- Në ambientet e UBT-së, është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndëruniversitar në mes të UBT-së dhe Universitetit të Varshavës në Polonia.

Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hjarizi, së bashku me delegacionin nga Universiteti i Varshavës nga Polonia, i përbërë nga zëvendësrektorja prof. Marta Kicinska-Habiovr, prof. Edward Halizak dhe dr. Jakub Zajackowski, i kanë ftuar zyrtarisht të gjithë profesorët vendorë dhe ndërkombëtarë si dhe studentët që të bëhen pjesë e programeve të përbashkëta, të cilët ata i kanë prezantuar.

"Kjo marrëveshje do t'ua mundësojë studentëve të UBT-së dhe atyre kosovarë që studimet universitare në nivelin bachelor, master dhe në doktoraturë nëpërmjet UBT-së t'i ndjekin në Universitetin Varshavës në Polonia, po ashtu stafit akademik zhvillim e kompetencës në fushën hulumtuese dhe zhvillimore. Bashkëpunimi do të ofrojë edhe programe të tjera të veçanta siç janë projektet, seminarët, transferi i teknologjisë, dhe takime tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet", ka theksuar presidenti i UBT-së, Edmond Hajrizi.

Ndërkaq zëvendësrektorja prof. Marta Kicinska-Habiovr, para të pranishmëve është shprehur e kënaqur me të arriturat e UBT-së, sidomos me programet e studimit me teknologjinë më moderne, me infrastrukturën, me stafin akademik dhe me arritjet e studentëve. "Shpreh kënaqësinë time që vizitoj Kosovën me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes për bashkëpunim në mes UBT dhe Universitetit të Varshavës.

Bashkëpunimi ndëruniversitar në mes UBT dhe Universitetin të Varshavës, ka filluar edhe më herët nëpërmjet projektit "Erasmus Mundus", për shkëmbim të studentëve dhe stafit. Hajrizi, gjatë kësaj vizite dhe takimit e njëpasnjëshme që i zhvilloi me menaxhmentin më të lartë në Universitetin e Varshavës, u njoh me zhvillimet në këtë universitet, me theks të veçantë me punën që bëhet në të gjitha fakultete.

Universitetit i Varshavës është themeluar në vitin 1816,



dhe sot renditet në 4% të universiteteve të kategorisë botërore dhe si universitetin numër një në vend. Është universitet gjithëpërfshirës publik, dhe më i madhi në vend, me 54 mijë studentë, 3500 staf akademik dhe ligjërues. Ka bashkëpunim ndërkombëtar me përmasa botërore, me 240 marrëveshje bashkëpunimi universitar në 54 vende botërore, me 1600 marrëveshje bashkëpunimi, 1000 nga to në kuadër të programin 'Erasmus Mundus', të Unionit Evropian, dhe është anëtar aktiv në kuadër të këtij projekti", është shprehur ajo. Pas aktit solemn të nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, mysafirët nga Vrahava së bashku më menaxhmentin e lartë të UBT-së e kanë vizituar kampusin e ri universitar, dhe kanë marrë pjesën në hapjen e Ekspozitës Tradicionale "UBT 2012", në të cilën janë ekspozuar punimet e studentëve të Departamentit të Arkitekturës të këtij universiteti.

Përfaqësuesit e Universitetit të Varshavës, para studentëve kosovarë dhe të pranishmëve tjerë, po të hënën në ora 17.30, mbajtën edhe një ligjëratë publike nga lëmi i shkencave politike, si dhe kanë folur për të arriturat e Universitetit të Varshavës.

UBT lidh marrëveshje me TU Clausthal dhe Universitetin e Freiburgut



Prishtinë 7 shkurt 2013- Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, bashkë me prof. dr. Ibrahim Krasniqin, gjatë qëndrimit të tyre njëjavor në Republikën e Gjermanisë, zhvilluan një varg takimesh me rëndësi, ku njëkohësisht u takuan me krerët më të lartë të universiteteve të vendit.

Kështu, në Universitetin për Teknologji- Clausthal, në Gjermani, Prorektori për Çështje Akademike prof. dr.- Ing. Oliver Langefeld, përpos mikpritjes së përzemërt, pati një takim të përbashkët dhe të rëndësishëm me palët kosovare, në objektin e Universitetit për Teknologji -Clausthal, dhe u arrit në parim një marrëveshje për bashkëpunim ndëruniversitar me UBT-në. Në takim ishte e pranishme edhe Drejtoresha për Marrëdhënie Ndërkombëtare, në kuadër të Universitetit për Teknologji të Clausthallit, znj. Romanovski e cila gjithashtu e përkrahu një bashkëpunim të tillë.

Më konkretisht, kjo marrëveshje parasheh mundësimin e bashkëpunim ndëruniversitar në të gjitha nivelet e studimit, si dhe shkëmbimin e stafit akademik dhe të studentëve, projekte të përbashkëta zhvillimore dhe hulumtuese, studentët të organizojmë seminare dhe takime të tjera akademike për çështje shkencore, përdorimin e bibliotekave përkatëse për nevoja të studimeve dhe hulumtimeve shkencore, programe të studimit në distancë, zbatimin e përbashkët të programeve studimore, aktivitetet lidhur me kurset verore dhe takime të tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet.

Z. Hajrizi dhe z. Krasniqi, gjatë kësaj takimeve me menaxhmentin më të lartë në Universitetin për Teknologji Clausthal, u njohën me zhvillimet në këtë universitet, me theks të veçantë me punën që bëhet në të gjitha fakultetet, më konkretisht, prof. Langefeld, e ka njoftuar z. Hajrizin lidhur me zhvillimet e përgjithshme dhe vizionin për zhvillim të mëtejshëm në këtë institucionin.

Përveç marrëveshjes, gjatë kësaj vizite, pala kosovare, me ftesë të menaxhmentit të universitetit në fjalë, ka vizituar edhe disa institute dhe laboratorë të teknologjinë në moderne që ka shteti gjerman, të instaluar nëpër universitete për praktikë të studentëve, stafit dhe partnerët që ka ky universitet.

Përveç Universitetit të Clausthalit, Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, bashkë me prof. dr. Ibrahim Krasniqin, zhvilluan edhe një takim shumë të rëndësishëm në Universitetin e Freibergut, ku u takuan me zëvendësdekanin e Fakultetit dhe njëherësh Drejtorin e Institutit për Shkenca Materiale, prof. dr. Ing. Thomas A. Bier.

Dy krerët e dy institucioneve biseduan për të gjitha mundësitë e bashkëpunimit, në një të ardhme të afërt, si në fushën e shkencave të materialeve, ndërtimin e infrastrukturës laboratorike por edhe projekte të përbashkëta shkencore dhe profesionale, në të gjitha nivelet e studimit, dhe për projektet e përbashkëta në nivel evropian dhe rajonal, shkëmbimin e literaturës më të avancuar dhe për çështje të tjera akademike të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet. Me këtë rast u arrit pajtimi dhe u nënshkrua marrëveshja e kooperimit të ndërsjellë, e cila do të mundësojë shkëmbim universitar të të gjitha niveleve.

Prof. Hajrizi dhe prof. Krasniqi vizituan edhe Muzeun Nacional të Kristaleve, më të madhin në botë, dhe u njohën me të arriturat e tij të vazhdueshme.

Që të dyja këto universitete të shtetit gjerman numërojnë një numër të konsiderueshëm të mësimdhënësve dhe kanë marrëveshje shumta bashkëpunimi me universitete në të gjitha kontinentet e botës, dhe janë themeluar ndër universitete e para në kontinentin e Evropës, ku numri i të diplomuar nga këto universitete është i krahasueshëm me universitete më të mëdha në botë, po ashtu të diplomuarit sot janë në vende udhëheqëse nëpër kompani dhe organizata më profitabile në mbarë botën. Po ashtu të dyja janë ndër universitetet më me repute në Republikën e Gjermanisë dhe më gjerë, me një traditë qindrvjeçare në fushën akademike dhe shkencore.

Prof. dr. Hajrizi dhe prof. dr. Krasniqi, gjatë vizitës në Universitetin e Freibergut, u takuan gjithashtu me prof. dr.-Ing. Habil. H Oettel, i cili gjithashtu shprehu gatishmëri për bashkëpunim në të gjitha fushat e mundshme në të mirë të dy universiteteve.

Sipas mikpritësve ky ishte vetëm hapi i parë në rrugën e një bashkëpunimi të mirëfilltë dhe afatgjatë për të ardhmen.

Tahiri nga UBT menaxher në PTK

UBT Alumni: Si keni vendosur të studio- ni në UBT?

Mentor Tahiri: Pas luftës jam punësuar. Përkundër dëshirës që të studioj në shkencë politike, për mua ishte e pamundur të përcjellë studime gjatë orarit të punës, ashtu siç ofronte atëherë Universiteti Publik si institucion i vetëm. Gradualisht filluan të hapen edhe institucione private të edukimit universitarë. Gjithsesi, kjo vlen edhe sot, duhet shikuar mirë se ku studenti regjistrohet, nuk ia vlen kudo. UBT më është rekomanduar nga njerëz të afërt si institucioni më serioz universitarë. Në ndërkohë në kuadër të UBT-së, u hap Fakulteti Ndërkombëtarë për Drejtësi, Shkencë Politike dhe Diplomaci, kjo më zgjoi interesimin. Pasi që ligjëratat mbaheshin në orar që nuk binte ndesh me orarin e punës, vendosa të regjistrohem.



UBT Alumni: Çka ju ka lënë më së shumti përshtypje gjatë studimeve në UBT?

Mentor Tahiri: Programi, mënyra e konceptimit të studimeve, përbërja e kuadrove, e bëjnë UBT-në unike dhe lirisht them paraprijëse të një programi universitar të avancuar në Kosovë. UBT duhet të mburret për këtë, shtuar këtu edhe faktin se UBT është një institucion i themeluar në Kosovë. Duke qenë se isha student në kuadër të Fakultetit Ndërkombëtarë për Drejtësi, Shkencë Politike dhe Diplomaci, ku ligjëratat zhvilloheshin në gjuhën angleze dhe gjermane, kisha nderin që të kem ligjërues eminent nga pjesë të ndryshme të botës. Ende sot e kësaj ditë më fascinon gatishmëria dhe mundësia të cilën UBT ia ofroj studentëve të gjeneratës time. Ndonëse fizikisht në ligjëratat vijonim në Prishtinë, ishim në të gjitha aspektet pjesë e një sistemi botëror të edukimit, ku mësonim më të mirën nga më të mirët. Edhe në biseda me profesorët tanë ligjërues, ne kuptonim se ishim në kushte të njëjta të studimeve sikurse në Vjen, Berlin apo gjetiu.

UBT Alumni: UBT njihet si institucion që ka sjellë dhe vazhdon të sjellë në Kosovë profesorë eminentë nga e gjithë bota. Si e keni vlerësuar këtë fakt dhe sa konkretisht ju kanë ndihmuar ata?

Mentor Tahiri: Tani po të përmendja të gjithë ata profesorë me emër do të ishte e tepërt, por nuk mund të mos përmend, të respektojmë Profesorin Ernst Florian Winter, themeluesin dhe drejtorin e parë të Akademisë Diplomatike të Vjenës. Jo vetëm që na ofronte eksperiencën e tij të madhe të veprimtarisë politike-diplomatike të bërë gati në çdo cep të botës si diplomat austriak dhe amerikan, por edhe përmes tij ne shihnim gati si para syve tanë, të gjitha proceset politike botërore. Ernst Florian Winter jo vetëm që zotëronte gjuhët kryesore të civilizimit perëndimorë, por duke qenë një poliglot i vërtetë ishte në gjendje të na përkthente edhe burime profesionale nga gjuhët kineze dhe japoneze. Profesor Winter e ka shumë përzemër Kosovën. Gatishmëria e tij e madhe për të ndihmuar këtu dhe ofruar ekspertizën e tij në shumë lëmi, kam përshtypjen që këtu nuk është kuptuar asnjëherë sa duhet. Personalisht kam nderin që Profesori Winter ishte mentori im gjatë punimit të temës së diplomës, të cilën e kam mbrojtur para komisionit të kryesuar nga ai. Gjithashtu, nuk mundem asnjëherë të harroj ligjëratat e zhvilluara nga Profesor Michel Cullin nga Franca, Leothar Tschapka nga Austria, Rei Shigeno nga Japonia, Mateas Wachter nga Gjermania, Jonathan Tenenmbaun nga SHBA-të dhe shumë të tjerë. Secili nga ata, vinte nga kultura të ndryshme dhe me eksperiencën të ndryshme

por jashtëzakonisht të dobishme për studentët. Fakulteti Ndërkombëtar për Drejtësi, Shkencë Politike dhe Diplomaci, në çdo aspekt praktik ishte shndërruar në një akademi diplomatike të pushpallur si të tillë, por që dëshmoi se mund të funksionon në mënyrë perfekte edhe këtu tek ne në Kosovë, nevojitet vetëm përkushtimi profesional dhe serioziteti i duhur siç është në UBT.

UBT Alumni: Po kështu, UBT ofron edhe mundësinë e udhëtimeve studimore. Sa ju kana ndihmuar Juve konkretisht këto vizita?

Mentor Tahiri: Çdo vizitë e tillë është eksperiencë në vetvete. Kam pasur rastin që si student i UBT-së të vizitoj disa institucione të rëndësishme në vend jo vetëm politike apo administrative, por edhe ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë e vendit. Vizita të ngjashme mendoj se duhet të jenë pjesë e çdo programi studimor, ngase i mundëson studentit që të njoftohet edhe me anëtarë praktikë të asaj që i prezantohet në ligjëratat. Shtuar këtu edhe krijimin e kontakteve profesionale qysh gjatë kohës sa je student. Fatkeqësisht, në UBT, nuk pati program master për profilin e studimeve që kam mbaruar dhe këtë e konsideroj hendikep të madh. Për të mos ndryshuar profilin, jam detyruar që studimet t'i vazhdoj në një institucion tjetër.

UBT Alumni: A mund të na thoni konkretisht ku jeni duke punuar, cili është pozicioni Juaj dhe sa në të vërtetë keni arritur në karrierë deri tash?

Studimet në UBT kanë ngritur ndjeshëm përgatitjen profesionale. Kam një përvojë shumëvjeçare në udhëheqje dhe menaxhim. Deri tani kam qenë i angazhuar në pozitën e Drejtorit Menaxhues në dy projekte. Tani, në kuadër të PTK-së, jam menaxher i shërbimit logjistik në nivel të Kosovës, Menaxher i Transportit të PTK-së. Gjithashtu aktivisht merrem edhe me publicistikë duke publikuar shkrime autoriale në gazeta në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni. Nuk jam ndaluar asnjëherë së shkruarit dhe aktualisht jam duke përgatitur për botim, librin tim të parë i cili ka të bëjë me disa aspekte të ndërhyrjeve politike-ideologjike në marrëdhëniet ndërkombëtare, më konkretisht libri flet mbi ndikimin e Pan-Sllavizmit, i cili edhe sot vazhdon të jetë aktiv dhe po pengon seriozisht integrimin e Republikës së Kosovës në shumë mekanizma ndërkombëtare, madje edhe gjithë-botërore. Një version i shkurtuar elektronik i librit është i lancuar në internet.

UBT Alumni: Ju lutem, mund t'i shtoni kësaj bisede edhe ndonjë element tjetër që juve ju duket më rëndësi.

Mentor Tahiri: Më pëlqen tradita e krijuar në UBT, për ruajtjen e lidhjeve me studentët e dikurshëm të UBT-së, pra me ata që kanë diplomuar aty. Kujdesi mbi "Alumnin" tregon vetë seriozitetin institucional që UBT ka kultivuar gjatë gjithë këtyre viteve. Mua personalisht, edhe pas gjithë këtyre viteve, më bën të ndjehem pjesë e familjes dhe ma konfirmim edhe më fuqishëm atë që si student e dalloja tek themeluesi dhe udhëheqësi i UBT-së z.Hajrizaj, vizionin e tij për krijimin e një tradite në kualitet dhe profesionalizëm. Përndryshe, të konceptuarit dhe të punuarit drejt me "Alumnin" përveç që mban të gjalla lidhjet, gjithashtu krijon predispozita, që të ardhmen këta studentë t'i kthehen përsëri UBT-së në formë të ndryshme të bashkëpunimit profesional, përfshirë këtu edhe atë akademik.

Arta: Jam kthyer në Kosovë t'i kontribuoj vendit tim



Arta Hyseni, pas përfundimit të studimeve themelore në Fakultetin Manaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, menjëherë fillon interesimin për studime të mëtutjeshme dhe për një kohë shumë të shkurtër fiton bursë nga organizata DAAD-OSI scholarship dhe vazhdon për master, program dy vjeçar, në drejtimin

International Finance and Economics në Universitetin "Otto von Guericke Magdeburg University" në Gjermani. Pas dy vite pune dhe shumë angazhime, Arta diplomon me temën "Financial markets and coordination games-

bank run". "Kjo temë ka të bëjë më shumë me periudhat e krizës financiare. Psh, një kompani angleze shumë të njohur "Northern Rock", e cila gjatë vitit 2007 ka pësuar bank run që do të thotë se një numër i madh i depozitave kanë krijuar një radhë para bankës për t'i tërhequr depozitat e tyre duke besuar se banka do të bankrotonte. Në fakt "Northern rok" ka qenë në kushte të mira", tha Arta, e cila gjatë këtyre ditëve ka lënë Republikë e Gjermanisë dhe është kthyer në vendlindje ku është punësuar në kompaninë e auditimit "Deloitte", dmth ka rolin e auditorës. Për gazetën "UBT News", thotë se gjatë tërë kohës së studimeve ka menduar të kthehet dhe njohuritë e fituar t'i aplikoj në vendin e vet, dhe menjëherë pas përfundimit të studimeve është kthyer në Republikën e Kosovës.

U nënshkrua marrëveshja me Universitetin "Mimar Sinan" në Stamboll

Prishtinë, 8 maj 2013- UBT në vazhdimësi po bashkëpunon me universitetet të njohura botërore, për bartjen dhe shkëmbimin e përvojave në fushën universitare. Një bashkëpunimi i tillë është duke e vazhduar edhe me universitete nga Republika e Turqisë.

Një delegacion nga UBT, i prirë nga Dekani i Departamenti të Arkitekturës në UBT, dr. Binak Beqaj dhe can. dr. Ajhan Bajmaku, ka qëndruar për vizitë disaditore në Turqi, gjegjësisht kanë vizituar Universitetin "Mimar Sinan" ku kanë takuar menaxhmentin e lartë të këtij universiteti, me të cilët është nënshkruar edhe marrëveshja e bashkëpunimit në fushën akademike, shkencore dhe atë kulturore në mes këtyre universiteteve.

Më konkretisht marrëveshjen e bashkëpunimit e nënshkruan prof. Binak Beqaj dhe dekanja i Fakultetit të Arkitekturës në Universitetin "Mimar Sinan", prof. dr. Guzin Konuk.

Është diskutuar edhe për zhvillimin e kurrikulave, mobilitetin e stafit akademik dhe të studentëve, organizimin e eventeve shkencore me nivel regional dhe ndërkombëtar, si dhe pjesëmarrjet e përbashkëta në projekte evropiane.

Po ashtu, gjatë kësaj vizite prof. Beqaj u prit edhe nga Prorektori i Universitetit në fjalë, prof. Caner Karavit.

"Ishte një shkëmbim shumë i mirë përvojash për ne, sepse këto universitete vërtetë kanë bërë një zhvillim të madh dhe kanë krijuar emër në fushat e studimeve të cilat ato i ofrojnë. Prandaj, është interesi ynë që praktikat e mira turke të barten edhe në Kosovë", tha dr. Binak Beqaj, Dekan i Departamentit të Arkitekturës në UBT.

Po ashtu prof. Binak Beqaj, para stafit dhe studentëve të Universitetit turk dhe atë kosovarë, po në objektin e Universitetit "Mimar Sinan", mbajti edhe një ligjëratë me temën "Menaxhimi i zhvillimeve arkitektonike dhe urbane për vendet në zhvillim".

Ligjëratë është mirëpritur nga të pranishmit, në bazë të tematikës aktuale të prezantuar dhe ligjërimit profesional, i cili pas përfundimit të ligjërataë ka zhvilluar një debat më studentët dhe mësimsdhënësit.

Po ashtu Prof. Beqaj, zhvilloi edhe një takim pune me studentët kosovarë që studiojnë në studime Master dhe Doktoratë në këtë universitet.



Në UBT kemi gjetur një ambient për të ndjekur studimet pa shkëputje nga puna

UBT Alumni: Si keni vendosur të studioni në UBT. Çka ka qenë shtytja juaj kryesore për të studiuar në këtë universitet?

Gëzim Kurshumliu: Për shkak të mospotësisimit të kushteve për mësim për studentët me korrespondencë kemi vendosur si grup prej disa studentëve të transferohemi nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore, në UBT, ku kemi përcjellë studimet për një vit. Kup-tohet që profesioni që kishim zgjedhë kërkonte patjetër mbajtjen e ligjëratave dhe konsultimeve me profesorë të cilat si pjesë e studentëve pa shkëputje nga puna nuk i kemi pasur në UP. Ndërkohë në UBT kemi gjetur një ambient të mirë për të ndjekur studimet pa shkëputje nga puna. Ndërkohë kushtet për studentë kanë qenë mjaft të mira dhe në përputhje me standarde për çfarë jam i bindur UBT ka marrë edhe certifikatën për plotësimin e ISO standardeve.

UBT Alumni: A mund të na rrëfeni diçka nga studimet tuaja në UBT. Çka ju ka lënë më së shumti përshtypje?

Gëzim Kurshumliu: Përshtypje mjaft të mira kam për mënyrën e sqarimit dhe diskutimit me studentë sidomos nga profesorët nga Austria si Bernard Putz e të tjerë. Mund të them që edhe grupi i studentëve në këtë gjeneratë kanë qenë shumë bashkëpunues në mes vete gjë që ka sjellë rezultate maksimale në mësim.

UBT Alumni: UBT njihet si institucion që ka sjellë dhe vazhdon të sjellë në Kosovë profesorë eminentë nga e gjithë bota. Si e keni vlerësuar këtë fakt dhe sa konkretisht ju kanë ndihmuar ata?

Gëzim Kurshumliu: Kuptohet që eksperiencat e bartura edhe nga jashtë Kosovës janë shumë të mira sidomos për një vend në tranzicion siç jemi ne. Ka qenë privilegj të jem në ligjërata me profesorë nga vende të ndryshme si Austria e nuk mund të harroj as profesoreshën Mitra Arami, për mënyrën se si barte njohuritë për Project Management përmes elementeve shumë të thjeshta e sidomos mënyrën se si jepte prioritet shumë të madhe punës në grupe që besoj i duhet shumë çdo student.

UBT Alumni: Pas diplomimit, Ju tani po zhvillon karrierë të suksesshme. A mund të na thoni konkretisht



ku jeni duke punuar, cili është pozicioni juaj dhe sa në të vërtetë keni arritur në karrierë deri tash?

Gëzim Kurshumliu: Aktualisht punojë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (përgjegjës për të gjitha Gjykatat në Kosovë) pas diplomimit jam avancuar në detyrë nga zyrtar i TI-së në Administrues të rrjetit të KGJK-së gjatë kësaj kohe përveç studimeve jam certifikuar edhe nga Microsoft ku kam fituar titullin MCITP dhe në Cisco për CCNA ku pa dyshim që certifikimin e kanë bërë më të lehtë edhe njohuritë e fituara nga UBT.

UBT Alumni: Në profesionin Tuaj dhe në detyrat e përditshme të punës, takoheni me probleme e situata të ndryshme. Sa mendoni se ju ndihmon në zgjidhjen e detyrave të punës apo çështjeve të biznesit a çështjeve të ndryshme përvoja që keni fituar gjatë studimeve në UBT?

Gëzim Kurshumliu: Siç e ceka më herët përveç diplomës që kam marrë nga UBT që më ka ndihmuar mjaft në avancimin në detyrë, kam fituar edhe eksperiencat nga më të ndryshmet, disa prej të cilave veç janë cekur më lart. Përveç kësaj, punën që e bëj sot deri para një viti është bërë nga kontraktuesit të cilët i kanë kushtuar buxhetit të Kosovës deri dhjetëfishin e shumë për të cilën sot e bëjë unë. Pra, njohuritë që i ka plasuar UBT-ja më kanë ndihmuar së pari që të kem një vend pune që paguhet mirë krahasuar me mesataren e pagave në Kosovë si dhe ka ndikuar në kursimin e parave të shpenzuara nga buxheti i Kosovës.

UBT Alumni: Ju lutem, mund t'i shtoni kësaj bisede edhe ndonjë element tjetër që juve ju duket më rëndësi.

Gëzim Kurshumliu: Të vazhdohet me studime cilësore, të punohet shumë më shumë me studentë në drejtim të avancimit të njohurive të tyre, gjithnjë duke i kombinuar njohuritë e fituara përmes ligjëratave dhe bashkëpunimit mes studentëve dhe profesorëve. Të organizohen sa më shumë seminare, punime shkencore dhe aktivitete të tjera që e bëjnë një universitet të jetë në hapë me kohën, siç e bën UBT-ja me kampionatin në robotikë etj.

Prof. Matyas ka ligjëruar në UBT

Prishtinë, 10 maj 2013- Në UBT vazhdimisht ligjërata zhvillohen edhe nga personalitete dhe profesorë të fushave të ndryshme të botës akademike, shkencore etj.

"News developments in production and logistics", ishte tema e ligjërates, ku para studentëve të Departamentit- Menaxhment i Mekatronikës, në UBT, ka ligjëruar profesori nga Universiteti Teknik i Vjenës, prof. dipl.-Ing. dr. Kurt Matyas.

Studentët përveç që u ndan të kënaqur me ligjërimin e profesorit Matyas, ata përfituan njohuri të reja nga fushë e cekur më lartë.




Mirëllinda: Në UBT dhe në Teb-Bankë!

Si gjithë studentët tjerë të UBT-së edhe Mirëllinda Sahiti-Krasniqi, me mbarimin e studimeve themelore në Departamentin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, në gjuhën angleze, menjëherë punësohen në Teb-Bankë, në pozitën Zyrtare e Portofolios së Personave Individual, dhe krahas punës Mirëllinda vazhdon edhe studimet e nivelit Master, po në të njëjtin institucion dhe departament.

Znj. Krasniqi, për revistën "UBT Alumni" thotë se përvoja me profesorët e huaj ka qenë diçka e jashtëzakonshme, që na kanë bërë të ndihemi sikur të jemi duke studiuar në ndonjë universitet jashtë Kosovës dhe mundësia e vizitave në institucione dhe kompani të ndryshme, na ka ndihmuar shumë, sepse kemi parë që nga afër se si zhvillohet puna, dhe më konkretisht si bëhet menaxhimi i një kompanie.



Lauriku, studimet themelore i ka përfunduar në TU në Vjenë kurse ato të Masterit në UBT



UBT në kuadër të programeve të shumta që ka për ecjen e saj drejt ndërkombëtarizimit, mjaft të zhvilluar e ka edhe Programin për shkëmbimin e studentëve, ku studentët të cilët shprehin dëshirë të bëhen pjesë e UBT-së në të gjitha nivelet e studimeve, mund të bëhen edhe pjesë e studimeve jashtë vendit, në

universitetet më prestigjioze në Evropë dhe botë dhe anasjelltas, ata nga Universitete e vendeve të cekuar më lartë mund të bëhen pjesë e studimeve e të gjitha niveleve në UBT.

Laurik Helshani, i cili studimet themelore i ka përfunduar në Universitetin Teknik të Vjenës, në drejtimin Software & Information Engineering, kurse ato të Masterit dhe me një sukses shumë të lartë në fund të vitit të kaluar i ka mbaruar në UBT në drejtimin Shkenca Kompjuterike.

"Kolegialisht kemi vendosur të studiojmë në UBT, së bashku me menaxherin e degës së kompanisë "Kujtesa.NET-it" në Gjakovë dhe shtytja jonë për të vijuar studimet në këtë universitet ka qenë planprogrami i studimeve, që është një kombinim i dy universiteteve të huaja, atij austriak dhe anglez", tha Laurik Helshani, për revistën "UBT Alumni".

Ai më tej shton dhe e vlerëson lart ardhjen e profesorëve të huaj në UBT, të vazhdoj edhe më tutje, sepse mendoj që shërben në shkëmbimin e ndërsjellët të përvojave në mes të studentëve dhe mësimeve të huaj.

Lauriku po zhvillon një karrierë të suksesshme. Si para studimeve, gjatë kohës së studimeve dhe më pas, ka punuar dhe vazhdon të punoj në "Kujtesa.NET", në Prishtinë, si Menaxher i Programeve. Ai më tej shton se gjatë studimeve në UBT, njohuritë i ka zgjeruar në lëmi të rrjeteve dhe protokolleve të ndryshme në to. "Njohja teorike e tyre do të ma lehtësojë programimin në rrjeta dhe në sistemet e shpërndara (Distribution Systems)", përfundoi Lauriku për revistën "UBT Alumni".



Merita: E ardhmja e studentëve të UBT është e sigurt dhe e pakontestueshme

“Shkëmbimi i përvojave të ndryshme nga profesorë të njohur ndërkombëtar bëjnë që UBT të vazhdojë të mbetet një universitetet lider në aspektin e cilësisë së edukimit të lartë në Kosovë”, tha Merita Gjyshinca- Peja

UBT Alumni: Si keni vendosur të studioni në UBT. Çka ka qenë shtytja juaj kryesore për të studiuar në këtë universitet?

M. Gjyshinca- Peja: Pas mbarimit të Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Prishtinës, vazhdova një program dis-amujor në Londër “Young Business Programme”, program ky i dedikuar për të rinjtë të cilët sapo kanë mbaruar fakultetin dhe janë në fillim të karrierës së tyre. Pas kthimit nga Londra, synimi im ishte të vazhdoja studimet post-diplomike në një universitet me cilësi dhe renome, universitet i cili gërshetohet përvojat vendore dhe ato ndërkombëtare, dhe pikërisht UBT ishte zgjedhja ime dhe ajo që unë kërkoja. Në UBT shumica e profesorëve të cilët kanë ligjëruar kanë qenë pikërisht ata të cilët ligjëronin në universitetet e njohura ndërkombëtare në Evropë, duke filluar nga WUT e deri në Oakland University, në Amerikë, prandaj kjo ishte një shtytje shtesë për mua pse unë vendosa të studioj pikërisht në UBT.

UBT Alumni: A mund të na rrëfeni diçka nga studimet tuaja në UBT. Çka ju ka lënë më së shumti përshtypje?

M. Gjyshinca-Peja: Unë kam qenë e impresionuar në përgjithësi me cilësinë e mësimdhënies dhe sidomos mënyrën se sa bashkëpunues dhe miqësorë ishin mësimdhënësit tanë. Unë do të veçoja një kombinim të ligjërimit me shembuj praktikë në fushën e menaxhmentit dhe praktikave të ndryshme të kompanive me renome botëror, detyrat dhe puna ekipore, netët e gjata pa gjumë, si dhe vizitat në kompani të njohura në Austri ende mbesim mbresëlënëse për mua.

UBT Alumni: UBT njihet si institucion që ka sjellë dhe vazhdon të sjellë në Kosovë profesorë eminentë nga e gjithë bota. Si e keni vlerësuar këtë fakt dhe sa konkretisht ju kanë ndihmuar ata?

M. Gjyshinca-Peja: Definitivisht, shkëmbimi i përvojave të ndryshme nga profesorë të njohur ndërkombëtarë bëjnë që UBT të vazhdojë të mbetet një universitetet lider në aspektin e cilësisë së edukimit të lartë në Kosovë. Ne kemi qenë ndër grupet e para të studentëve të cilët kemi mbaruar programin e Masterit në UBT dhe falë përvojës së jashtëzakonshme në këtë universitet, rrjedhimisht kemi rekomanduar edhe kolegët e tjerë të vazhdojmë studimet aty.

UBT Alumni: Po kështu, UBT ofron edhe mundësinë e udhëtimeve studimore në institucione prestigjioze ndërkombëtare me të cilat ka bashkëpunim, apo edhe vizita studimore në ndërmarrje e institucione të rëndësishme në vend. Sa ju kana ndihmuar juve konkretisht këto vizita?



M. Gjyshinca- Peja: Vizitat me karakter studimor në kompani të njohura në Austri, përvojat e ndryshme në fushën e menaxhimit dhe udhëheqjes, menaxhimit operacionial dhe produktivitetit kanë qenë pjesë të cilat ne kemi arritur që t'i implementojmë dhe praktikojmë në përditshmërinë tonë në punë.

UBT Alumni: Pas diplomimit, Ju tani po zhvillon karrierë të suksesshme. A mund të na thoni konkretisht ku jeni duke punuar, cili është pozicioni juaj dhe sa në të vërtetë keni arritur në karrierë deri tash?

M. Gjyshinca- Peja: Unë për afër 10 vitesh punoj në Banken Raiffesien. Fillimisht kam filluar si koordinator e degëve, për të vazhduar pastaj si udhëheqëse e kanaleve të distribuimit (rrjetit të shitjes) ku kam qëndruar për 5 vite. Pastaj kam kaluar në pozitën udhëheqëse e Segmentit për Individë dhe Premium, një biznes segmentet i suksesshëm në Bankë dhe në tregun kosovar në përgjithësi. Përgjatë përvojës sime, kam fituar disa çmime me rëndësi qoftë në nivel lokal apo edhe zyra qendrore në Austri, Raiffesien Bank International. Padyshim ky sukses është edhe kontribut i studimeve të avancuara të cilat kam ndjekur në UBT. Prandaj, këtu kam një mesazh për të gjithë ata të cilët dëshirojnë të studiojnë: “E ardhmja e studenteve të Universitetit UBT është e sigurt dhe e pakontestueshme, studioni në UBT dhe ju keni investuar në të ardhme e juaj të shkëlqyer”.

UBT Alumni: Në profesionin Tuaj dhe në detyrat e përditshme të punës, takoheni me probleme e situata të ndryshme. Sa mendoni se ju ndihmon në zgjidhjen e detyrave të punës apo çështjeve të biznesit a çështjeve të ndryshme përvoja që keni fituar gjatë studimeve në UBT?

M. Gjyshinca- Peja: UBT më ka mundësuar të shikoj dhe të analizoj me një reflektim kritik mbi jetën personale, akademike dhe shoqërore. UBT ka shumë për të ofruar, është e jona, të dimë të absorbojmë dhe të shfrytëzojmë këto njohuri në të ardhmen!

UBT Alumni: Ju lutem, mund t'i shtoni kësaj bisede edhe ndonjë element tjetër që juve ju duket më rëndësi.

M. Gjyshinca- Peja: Dhe, për fund, suksesi nuk matet vetëm me punë. Arsimimi nuk është vetëm ajo që ne kemi mësuar në fakultet. Mbi të gjitha, unë kam një familje të mrekullueshme, dhe i gjithë ky sukses nëse mund ta quaj, është falë përkrahjes së vazhdueshme të familjes sime, në veçanti dy djemtë e mrekullueshëm, Mali dhe Sharri të cilët mbesin motivi i punës sime!

“Distribution Channels Management in Banking Sector”, ka qenë tema e Masterit, të cilën e ka mbrojtur në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT. M. Gjyshinca - Peja, ka paraqitur hulumtimin e saj të mentorit Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe komisionit të përbërë nga Prof. Dr. Mo Vaziri dhe Prof. Dr. Ibrahim Krasniqi.

Mimoza: UBT mundësia e vetme në Kosovë

“Është një karakteristikë e UBT-së, që unë personalisht e vlerësoj dhe e çmoj si mundësi të vetme që e kemi në Kosovë”, tha, për revistën “UBT Alumni”, Mimoza Haliti, e cila studimet themelore i ka përfunduar në UBT, në Departamentin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, në gjuhën angleze.

Mimoza më tej shton se duke pasur parasysh që mësimet në shkollën e mesme i ndoqi në kolegjin Amerikan në Prishtinë në gjuhën angleze, dhe nga profesorë internacionale nga shtetet e ndryshme të botës, nuk kishte kuptim që studimet bachelor mos t'i vazhdojë me të njëjtin 'privilegj'. Lidhur më këtë dhe si opsion më të mirë dhe më të përshtatshëm e pa UBT-në.

Megjithatë, materiali i detajuar me literaturë të huaj, projektet e ndryshme që ne bënim, ligjëratat e veçanta nga profesorë internacionalë të kualifikuar që unë kam pas fati t'i kem, etj etj më kanë ndihmuar jashtëzakonisht shumë me qasjen e tyre ndaj lëndës përkatëse, si dhe punëve apo projekteve praktike që ata kanë shfaqur për ne, thotë ajo.

Punësohet në ProCredit Bank

Duke pasur parasysh tregun e punës shumë të ngushtë



në vendin tonë për punësim, e sidomos nëpër kompani të mëdha profesionale etj etj, një gjë e tillë tek Mimoza nuk është vërejtur, e cila tani, ka rreth dy vite që punon në bankën më të madhe në vend në ProCredit Bank, si këshilltare për klientë dhe është e kënaqur që asaj të paktën më është ofruar një punë menjëherë pas studimeve.

Përvoja që unë kam fituar gjatë studimeve në UBT, më shërben jashtëzakonisht shumë në zgjidhjen e detyrave apo problemeve në punë, thotë Mimoza.

Suka: Menaxher i financave në kompaninë “DEMI”



“UBT është vend i dijes dhe njerëzve të suksesshëm në Kosovë dhe më gjerë”, thotë Valon Suka, i cili studimet themelore i ka përfunduar në Departamentin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT.

Ai më tej cek se ligjërimin profesional dhe marrëdhëniet e mira në mes të profesorëve dhe studentëve, vizita e zhvilluar nëpër ndërmarrje e institucione të ndryshme të cilat i kanë ndihmuar më shumë se si të zhvillohen gjërat në praktikë dhe marrja e këshillave profesionale duke u takuar me

njerëz afaristë, ndjekja e internshipeve të shumta, si ajo mes UBT-së dhe MTI-së, e realizuar në Bankën BKT, dhe në “Raiffaisen Bank”, kanë qenë eksperiencia shumë të mira për ta filluar karrierën.

“Gjatë kësaj periudhe, kam marrë një eksperiencë të shkëlqyeshme duke vazhduar të punoj edhe më tutje në pozitën e Analistit Kreditor me një vlerësim dhe përkushtim në punën profesionale. Eksperiencia profesionale e marrë në aspektin financiar të bizneseve, më bëri që të angazhohem më shumë në menaxhimin e financave dhe Kontabilitetit ku aktualisht punoj në këtë drejtim si Menaxher i Financave në Mercedes Service “DEMI” në Prizren, dhe jam shumë i përkushtuar në punën që e bëj”, përfundoi Suka.

Visar Kastrati fiton bursë në Universitetin e Sheffield

Visar Kastrati, i cili studimet themelore i ka përfunduar më sukses të shkëlqyer në UBT, në Departamentin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, për vitin akademik 2012 - 2013, ka fituar bursë të plotë për vazhdimin e studimeve Master në Universitetin e Sheffieldit, i cili gjendet në Selanik të Greqisë.

Bursa është ofruar nga Universiteti i Sheffield-it në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës.

“Pas shpalljes së thirrjes për bursa postdiplomike nga Ministria e Arsimit, për në Universitetin e Sheffieldit, kam aplikuar dhe pas vlerësimit të dokumentacionit nga Universiteti i Sheffield-it, jam përzgjedhur njeri nga fituesit e bursës së plotë”, tha Kastrati. Ai më tej shtoi se duke studiuar në njërën nga Top Universitetet botërore

do t'i mundësojë atij një trokitje më të lehtë në praktikat dhe zhvillimet e fundit në fushën e teknologjisë, dhe më pas të kthehet në Kosovë që të ndaj përvojën dhe ekspertizën që ka fituar. Po ashtu ai vlerësoj se njohuritë e fituara në UBT, gjatë studimeve themelore me planprograme më bashkëkohoret dhe më një staf akademik tejet të përgatitur, i dhanë mundësinë që të përfitojë një bursë të tillë mjaft të vlefshme për ngritjen e tij akademike.

Më përfundimin e këtyre studimeve, përveç njohurive mjaft të larta që do ti fitoj, ai do të pajiset edhe me titullin “Master i Shkencave në Inxhinieri Softuerike dhe Telekomunikim”. Universiteti i Sheffield-it renditet i 66-ti në renditjen botërore të universiteteve dhe njëherit përbën 1% e universiteteve më të mira në botë.

Petriti ligjëron në UBT

“Arsyeja e parë për fillimin e studimeve Master në UBT ishte se ky Universitet ishte i vetmi institucion në Kosovë që kishte një program Master ë Fakultetin Arkitekturë. Së dyti ky program përfshinte jo vetëm Arkitekturën, si fushë studimi, por gjithashtu Menaxhimin e Projekteve dhe Rregullimin Hapësinor. Arsye e tretë ishte se programi Master ishte i organizuar dhe ndërtuar nga një grup i profesorëve dhe ekspertëve ndërkombëtar, që më pas më dha mundësi të shumta për marrjen të përvojave dhe informatave më aktuale që kishin të bënin me lëmin tonë”, thotë Petrit Ahmeti, lindur në Prishtinë, shkollimin fillor dhe të mesëm ka përfunduar në vendlindje. Studimet e nivelit “bachelor” ka përfunduar në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekture, Fakulteti Arkitekture në Universitetin e Prishtinës, kurse studimet postdiplomike në Fakultetin Arkitekturës, Planifikim Hapësinor dhe Menaxhimi i Projekteve në (UBT).

UBT-ja, sjellë në Kosovë profesorë eminentë nga e gjithë bota. Mënyra e studimit ishte shumë interaktive, mënyrë e cila linte hapësirë për shprehjen e kreativitetit dhe aftësive të studentëve. Gjithashtu edhe programi i studimeve, i cili për mendimin tim ishte i kompletuar, sa i përket përgatitjeve profesionale dhe akademike, citoi z. Ahmeti për revistën “Alumni”. Ai shtonë se UBT-ja njihet si institucion që ka sjellë dhe vazhdon të sjellë në Kosovë profesorë eminentë nga e gjithë bota, ku studentëve të fakulteti në fjalë ju kanë ndihmuar shumë, duke veçuar orientimin të cilin e kanë pasur gjatë këtyre studimeve, e që është shfrytëzimi sa më efikas i energjisë përmes ndërtimeve kualitative. Njohuri që ka fituar gjatë studimeve i kanë ndihmuar shumë, që në bashkëpunim me profesorët të fillojmë idetë e para për fillimin e implementimit projekteve me standardet më të larta të BE-së në Kosovë, tha ai. Po ashtu cek se UBT-ja ofron edhe



mundësinë e udhëtimeve studimore në institucione prestigjioze ndërkombëtare me të cilat ka bashkëpunim, apo edhe vizita studimore në ndërmarrje e institucione të rëndësishme në vend dhe mua personalisht, përveç njohurive që kam marrë gjatë kohës së studimeve në UBT, mu ka dhënë mundësia e udhëtimit në Austri, si rezultat i ftesës së një nga profesorët nga Vjena, ku kam pasur mundësinë e zgjerimit të njohurive të mia profesionale, si në aspektin teorik gjithashtu edhe në atë praktik në Carinthia University of Applied Sciences.

Gjithashtu edhe ekskursionet studentore të organizuara nga vet UBT.

Aktualisht z. Ahmeti është Zyrtar i Infrastrukturës në kuadër të zyrës regjionale në Kosovës të Caritas Luxembourg-ut, si dhe asistent në njërin nga lëndët në Fakultetin e Arkitekturës në kuadër të UBT-së. Njëkohësisht është duke punuar në fushën shkencore, e cila i përket fushës së arkitekturës dhe ndërtimit në përgjithësi. Konkretisht është autor i përkthimit të softuerit Passive House Planning Package (Pako për Projektimin e Shtëpive Pasive), në bashkëpunim me “PassivHaus Institut” nga Gjermania, të cilët janë krijues të standardit Passive House dhe të softuerit PHPP. Njëkohësisht është promotor dhe distributor i këtij softueri për rajonin shqip folës. Për për këtë nismë të tij, ka pasur përkrahjen edhe të profesorëve të UBT-së nga Austria. “Njohuritë që kam marrë gjatë studimeve në UBT, kanë pasur aplikim praktik gjatë punës sime të përditshme me profesion. Por, unë jam i sigurt që këto njohuri vetëm sa kanë filluar të aplikohen në Kosovë e që pritet të kenë një aplikim më të madh në fushën e arkitekturës paralelisht me zhvillimin dhe aplikimin e standardeve të BE-së në Kosovë”, përfundoi Petrit Ahmeti.

Prof. dr. Peter Kopacek diskutoi me studentët e UBT-së

Prishtinë, 11 mars 2013 - “Mekatronika dhe robotika sot dhe në të ardhmen”, ishte tema e radhës, për të cilën, para studentëve dhe stafit akademik të UBT-së, ligjëroj prof. dr. techn. dr. hc. mult. Peter Kopacek.

Të pranishëm në debat, përveç studentëve dhe profesorëve të UBT-së, morën pjesë edhe njohës tjerë të shquar nga bota ndërkombëtare nga fusha e robotikës, mektronikës e shkencës në përgjithësi, të cilët e përcollën me interesim debatin.

Më konkretisht profesor Kopaceku, gjatë kësaj ligjërate ka shtjelluar çështjen kritike në relacion të zhvillimeve në lëmin e robotikës në përgjithësi dhe mektronikës në veçanti, duke filluar me prezantimin e filleve të kësaj lëmie si arsyeja dhe nevoja e krijimit të saj në tregun e edukimit internacional, puna për krijimin dhe impaktin e saj në treg pas krijimit, dhe sukseset e inxhinierëve të kësaj lëmie në plotësimin e nevojave të tregut me inxhinier profesionistë të mektronikës.

Ndër të tjerat prof. Kopaceku, ka shtjelluar edhe trendet botërore të kësaj dege studimi, problemet dhe përparësitë mes tyre, por aplikimi i mektronikës në treg, industri dhe edukim, ishte një pjesë shumë e veçantë e prezantimit duke promovuar edhe fushëveprimet e kësaj lëmie në industri dhe rëndësia e saj për edukimin e brezave të rinj.

Po ashtu, profesori në fjalë, me theks të veçantë foli rreth arritjeve, problemeve dhe rrugë zgjidhjet në inteligjencën artificiale të robotëve apo pajisjeve në përgjithësi dhe kostot benefite mes atomatizimit total të sistemit dhe atij pjesërisht, duke llogaritur edhe përgjegjësin mbi punësimin e fuqisë punëtore të racës njerëzore, duke pretenduar edhe në rëndësin e madhe në ambientin shoqëror ekonomik të pajisjeve.

Profesor Kopaceku, zhvilloi dhe përgjigjën në vijim të debatit edhe në një varg pyetjesh e çështjesh të shtruar për diskutim nga pjesëmarrësit, profesorët dhe studentët e UBT-së.

UBT ka sjellë robotët e gjeneratës së fundit të NAO-së në Republikën e Kosovës

Prishtinë, 13 prill 2013 – Përveç vendeve nga Evropa, UBT është Universiteti i vetëm nga Republika e Kosovës dhe rajoni që ka sjellë robotët e gjeneratës së fundit të NAO-së në Republikën e Kosovës dhe në tërë Ballkanin, u tha në konferencë e organizuar me media, e cila u mbajt në ambientet e Universitetit UBT, në Prishtinë.

Në këtë konferencë Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, bashkërisht me prof. dr. Peter Kopacek nga Universiteti Teknik i Vjenës dhe Dekani i Departamentit të Mekatronikës, dr. Muzafer Shala, dhanë detaje rreth robotëve të rinj dhe sjelljen dhe rëndësinë e tyre në vendin tonë.

“NOA janë teknologjia e fundit e robotëve Humanoidë, dhe sipas bisedës që kam pas me kompaninë në Paris, këta robotë vijnë për herë të parë në Ballkan. Ky është një lajm i ri dhe më pozitiv për vendin tonë”, tha Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi.

UBT me fushën e robotikës është mjaft moti e familjarizuar, ku në kuadër të Departamentit të Mekatronikës, është edhe laboratori më modern që ekziston, jo vetëm në vend, por edhe në regjion, dhe aty janë të vendosur të gjitha llojet e robotëve, duke filluar nga robotët industrialë, robotët që luajnë futboll, e tash edhe robotët që po i prezantojmë sot.

UBT në gara të futbollit me robotë në nivel të Evropës, ka marr vendin e parë, dhe besojmë se me robotët e porsaardhur do të marrim pjesë për Kupën Evropiane dhe botërore, dhe besoj që edhe suksesi nuk do të na mungojë.

Diku rreth 20 universitete më të mëdha në botë e kanë këtë teknologji, ku në kuadër të këtyre universiteteve po hyn edhe UBT, dhe tash e tutje studentët dhe stafi i këtij Universiteti kanë mundësi dhe qasje në teknologjinë më të re shkencore dhe profesionale.

Prof. Dr. Peter Kopacek nga Universitete Teknik i Vjenës,

njëkohësisht profesor edhe në Universitetin UBT, tha se e vërteta është që robotët vetëm kanë hy në Kosovë, dhe ne po e zhvillojmë një teknologji të re, edhe në këtë rast robotët Humanoid janë si shembull shumë i mirë për fushën e mekatronikës.

“Mendoj dhe besoj që deri pas 10 viteve çdo kompani e Kosovës do të ketë robotët të tillë, dhe detyra ime dhe e shefit të UBT-së është që studentët t’i shërbejmë me teknologjinë e fundit në këtë drejtim, sepse universitetet duhet të mendojnë më herët për të ardhmen e zhvillimit të vendit në të gjitha sektorët në përgjithësi, e më shumë atë të teknologjisë. UBT ka Laboratorë e Mekatronikës, dhe ai laborator do të jetë shtëpia e ardhshme e këtyre robotëve.

Ndërsa Dr. Muzave Shala, përveç që bëri prezantimin dhe punën hulumtuese që po bëhet në Departamentin Mekatronikës, si në pjesën e robotikës dhe në atë të sistemeve industriale, bëri edhe ndërlidhjen e robotëve të porsaardhur, të cilët ofrojnë mundësi të hulumtimit në fusha të ndryshme si atë në shkencë kompjuterike dhe në shkencë tjera.

Kurse Kushtrim Dragusha, ligjëruese në këtë Departament, tha se interkomunikimi mes njeriut dhe robotit mundësohet përmes censorëve të cilët janë të montuar në robot dhe këta censorë mundësojnë prej komunikimit me zë dhe marrjes së komandave nga njeriu, gjithashtu mundësi të komandimit edhe me pamje përmes kamerave. Komunikimi me njeriun roboti e bënë përmes LED dritave altoparlanteve, që të jetë më natyrale. Fuqia e procesimit të të dhënave është e madhe dhe mundëson komunikim në kohë reale mes robotit dhe njeriut. Gjithashtu roboti ka censorin e drejtimit – qëndrimit në mënyrë që të detektojë se në cilën pozitë është dhe në rastet e rrëzimit të tij ngrihet në pozitën normale.



Dr. Beqaj: Libri do t'ju shërbejë studentëve dhe ekspertëve



“Menjëherë pas botimit, ka pasur kërkesa të mëdha nga studentët e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë për të pasur këtë libër, pra, është në treg në të gjitha trojet shqiptare”, tha prof. dr. Binak Beqaj

UBT Alumni: Përkushtimi juaj ndaj gjithë punës për të publikuar librin universitar “Projektimi i konstruksioneve arkitektonike”, si një ndër librat e para të kësaj fushe në gjuhën shqipe, dhe kjo deri më tani nuk është bërë nga studiuesit e tjerë në radhë të parë për interesin e studentëve, nga kjo rrjedh edhe pyetja rreth motivit që ju ka nxitur për tu angazhuar për të qenë autor i këtij libri?

Prof. Beqaj: Po, është e vërtetë se konstruksionet arkitektonike janë bazë për ekspertizën që ndërlihet me projektim dhe ndërtim. Për dekada me radhë ka munguar literatura profesionale në gjuhën shqipe për studentët tanë. Pra, fakti se deri në 2012 (sa i përket literaturës në gjuhën shqipe) studentët janë shërbyer me dispensa të ndryshme, dhe kjo më shumë më ka nxitur që të angazhohem dhe të botoj këtë libër, e cila besoj që do t’ju shërbejë jo vetëm studentëve për studime por edhe ekspertëve për punën e tyre profesionale.

UBT Alumni: Çfarë e bëjnë dalluese këtë libër universitar nga studimet e të tjerëve që i keni vënë në shënjestër?

Prof. Beqaj: Materiali që përfshihet në këtë libër është mirë i harmonizuar dhe qartë i prezantuar duke u bazuar në formulim të thjeshtë dhe të kuptueshëm, ky ishte edhe vlerësimi i recensentëve Prof. Dr. Fetah Jagxhiu dhe Prof. Dr. Misin Misini.

UBT Alumni: Libri “Projektimi i konstruksioneve arkitektonike” po vazhdon rrugëtim të suksesshëm dhe është pranuar mjaft mirë jo vetëm nga studentët por edhe nga profesionistët tjerë. Si autor a mund të na thoni cila është përmbajtja e këtij libri?

Prof. Beqaj: Po është e vërtetë, menjëherë pas botimit ka pasur kërkesa të mëdha nga studentët e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonia për të pasur këtë libër, pra,

është në treg në të gjitha trojet shqiptare. Përmbajtja e këtij libri trajton elementet që ndërlihen me: ndërtesat, elementet e ndërtesave, elementet konstruktive, sistemet konstruktive, ndriçimi, shkallët, kulmet, mbulesat, oxhakët dhe ndikimet në ndërtesa.

UBT Alumni: Në këso raste zakonisht studiuesve u bëhet pyetja e njëjtë, a ka vështirësi në angazhimin rreth publikimeve të mirëfillta?

Prof. Beqaj: Po, ka vështirësi të caktuara sepse nganjëherë përveç kohës dhe angazhimit që duhet dedikuar publikimit të një libri, autori edhe mund të ballafaqohet me vështirësi financiare për ta botuar librin, ku ne rastin tim i falënderoj sponsorët që kontribuuan që të botohet libri, veçanërisht me rastin e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë. Rol me rëndësi sa i përket infrastrukturës për të hartuar librin për mua kanë luajtur kushtet e mira që m’i ka ofruar UBT-ja.

UBT Alumni: Çfarë mendoni për pozicionin dhe vlerësimin e studiuesit nga shoqëria kosovare?

Prof. Beqaj: Akoma jemi në fazën fillestare të krijimit të vlerave të mirëfillta, por mendoj se çdo hap që bëjmë tani do të jetë i çmueshëm sidomos nga gjeneratat e ardhshme.

UBT Alumni: Botimet dhe publikimet që i keni realizuar në kohën e fundit, në vazhdimësi. Cili do të jetë studimi dhe publikimi juaj i ri për vitin 2013?

Prof. Beqaj: Vetë profesioni në UBT si ligjërues më obligon që të merrem në vazhdimësi me hulumtime dhe publikime. Vetëm vitin e kaluar kam qenë autor apo edhe bashkautor i më shumë se pesë publikimeve shkencore në revista brenda dhe jashtë vendit, që kanë dalë si rezultat i konferencave, simpoziumeve apo angazhimeve tjera. Edhe për këtë vit mendoj të vazhdoj të njëjtin temp, duke shtuar këtu edhe projektin për publikimin e librit tjetër universitar “Urbanizmi” në gjuhën shqipe, që do të jetë në funksion të studiuesve jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë.

UBT në qendër të zhvillimeve shkencore

“Është libri i parë dhe i vetëm në gjuhën shqipe, që studion në mënyrë teorike dhe praktike funksionimin e rrjetave kompjuterike”, tha z. Haxhijaha, për gazetën “UBT News”

UBT Alumni: z. Haxhijaha, çka ju ka nxitur më së shumti që të publikoni librin “Rrjetat kompjuterike”?

z. Haxhijaha: Ne jemi dëshmitar të zhvillimeve të hovshme të viteve të fundit në fushën e rrjetave kompjuterike në Kosovë. Unë kam pasur për qëllim që me librin “Rrjetat Kompjuterike”, të ndihmoj në përgatitjen dhe aftësimin e gjeneratave të reja për të ndërtuar dhe mirëmbajtur rrjetat kompjuterike të madhësive të ndryshme. Unë besoj se me ndihmën e këtij libri, studentët e UBT-së, do ta kenë më lehtë për t’i arritur këto qëllime. Prandaj Rektori i UBT-së, prof. Edmond Hajrizi, ka vendosur që libri tu shpërndahet falas studentëve të këtij Universiteti.

UBT Alumni: Çfarë e bëjnë dalluese këtë libër shkencorë nga studimet e të tjerëve të kësaj fushe?

z. Haxhijaha: Është libri i parë dhe i vetëm në gjuhën shqipe që studion në mënyrë teorike dhe praktike funksionimin e rrjetave kompjuterike. Unë shpresoj të kem plotësuar sadopak boshllëkun e literaturës në këtë fushë të shkencave kompjuterike. Libri si i tillë është duke u përdorur nga studentët e UBT-së si literaturë universitare, por në të njëjtën kohë ka kërkesë për këtë libër edhe nga studentët e universiteteve tjera, e këtu vlen të përmendet edhe Universiteti i Prishtinës, ku disa student të këtij Universiteti kanë bërë kërkesë zyrtare për kopje të librit që ata do ta përdorin si material, referencë për punimet e tyre në tema të diplomës. Kjo e vendos UBT-në dhe Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në qendër të zhvillimeve shkencore në Kosovë dhe në të gjitha trojet shqipfolëse.

UBT Alumni: Cila është esencjalja e këtij libri?

z. Haxhijaha: Fakti që promovimi i librit të parë për rrjetat kompjuterike në gjuhën shqipe është bërë për nder të 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, më ka bërë mua të ndihem i privilegjuar dhe jashtëzakonisht i respektuar nga Prof. Dr. Edmond Hajrizi, dhe kolegët e mi, të nderuar si Prof. Petrit Shala, Prof. Fisnik Prekazi, Prof. Krenare Pireva dhe Prof. Gazmend Bajrami.

UBT Alumni: Cili do të jetë studimi i ri e juaj?

z. Haxhijaha: Për momentin jam duke punuar në vazhdimin e hulumtimeve në fushën Protokollove të Internetit IPv6, si dhe në fushën e sigurisë në infrastrukturën Cloud Computing.

Intervistoi; Fidan Thaqi



Studenti i UBT-ë, qasje në Universitete amerikane



Kreshnik Ismaili, studimet themelore i ka përfunduar në UBT dhe menjëherë ka vazhduar studimet Master në Departamentin e Mekatronikës. Është student i dalluar dhe fitues i bursës nga Ipko Foundation. Krahas studimeve, z. Ismaili, ndjek edhe disa kurse online, në universitetet më të njohura në Amerikë, siç janë

MIT, Berkeley dhe Harvard.

“UBT është vetë fakti se për herë të parë në vend ka sjellë programin e studimit për Mekatronikën dhe shtytja ime kryesore ishte që edhe unë dëshiroja të isha pjesë e këtij Universiteti prestigjioz në Kosovë dhe rajon. Ai më tej shtonë se UBT ka sjellë dhe vazhdon të sjell profesor eminentë nga e gjithë bota, dhe këtë unë si ish studentë dhe tani studentë i Masterit e vlerësoj” .

Ismaili për revistën “UBT Alumni” thotë se gjatë studimeve themelore do të veçoja Kampionatin Evropian të robotikës, ku triumfua me vendin e parë. Kjo është njëra ndër ato që ne e arritëm si gjeneratë e parë falë angazhimeve tona, mirëpo, jemi shumë falënderues dhe mirënjohës për prof. dr. Edmond Hajrizi, na dha mundësinë duke e sjellë mekatronikën në Republikën e Kosovës.

Jam duke punuar në kompaninë “Ipko Telecommunications LLC”, pozicioni im është zhvillues i aplikacioneve. Se sa kam arritur në karrierën time deri tani nuk mundem të vlerësoj edhe shumë pasi që jam vetëm që disa muaj në këtë kompani, mirëpo për këto muaj duke i ditur edhe rrethanat e tjera në treg nga eksperiencia ime duke punuar me babin tim, i cili është inxhinier i elektronikës, kam vërejtur që nuk mundemi edhe shumë të aplikojmë mekatronikën ashtu si mekatronikë që studiohet, kështu që studentët e ri i porositi duke ju thënë mos u dekurajoni nga ky fakt po ne jemi ata që duhet të aplikojmë mekatronikën 100% në këtë vend.



Departamenti për Trajnime dhe Certifikime në UBT është shumë i angazhuar për të kontribuar në avancimin e shoqërisë kosovare në një shoqëri konkurrense, nëpërmjet trajnimeve tona profesionale, të cekura më poshtë:

Menaxhim

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Administrim Biznesi
- Menaxhimi i Kualitetit (ISO 9001:2000)
- Menaxhimi Strategjik
- Ngritja (Themelimi) e ndërmarjes së re
- Menaxhimi i Produktit
- Ndërtimi i Brendit
- Inxhinieringu Industrial
- Menaxhimi i Projekteve
- Menaxhimi i Proceseve
- Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit
- E-Biznes
- Transport dhe Logjistikë
- Sisteme Fleksibile të Prodhimit
- Prodhimi mbështetës
- Prodhim, Planifikim dhe Skedulim
- Menaxhimi i Ndryshimeve
- Menaxhimi i Rrezikut
- Menaxhimi i Ankesave
- Menaxhimi i Kohës
- Ndërmarrësi dhe Biznisplan
- Menaxhimi i Sistemeve Informative
- Prokurimi
- Menaxhimi i Konfliktit
- Përgjegjësia Sociale e Korporatës
- Menaxhimi i Ngjarjeve
- Sistemet HACCP
- Fuzionimi dhe Bashkimi
- Planifikimi i resurseve të manufakturës
- Planifikimi i Materialeve të Kërkueshme (MRP)
- Shkathësi negociimi
- Menaxhmenti i Logjistikës

Financa

- Raportim Financiar i Korporatës
- Tregtia e Jashtme/Doganat
- Analiza e Kostove
- Kontabilitet dhe Menaxhim i Financave
- Vendimmarrja Financiare
- Institucionet Financiare dhe Tregjet

Marketing dhe Shitje:

- Marketing dhe Shitje
- Planifikimi i Burimeve të Shpërndarjes
- Mjetet e IT për Marketing

- Menaxhimi i Lojalitetit
- Merchandising
- Modeli i Optimizimit të çmimeve
- Zhvillimi i Produkteve dhe Brendimi
- Menaxhimi i Shitjes
- Shitja Efikase dhe Teknikat e Shitjes
- Menaxhimi i Ankesave të Konsumatorëve

Shkathësi kryesore të këshillimit:

- Menaxhimi Personal
- Komunikimi
- Punët e suksesshme grupore
- Grupimi dhe Krijimi i Grupeve
- Periodizimi
- Kodi i Etikës së Këshilltarit
- Zgjidhja e Konfliktit
- Negocimi i Kontratës
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientët
- Shërbime Këshillimi për Marketing
- Menaxhimi i Proceseve Këshilluese

Gjuhët e huaja:

- Gjuhë angleze
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë frënge

Vërejtje e rëndësishme: Gjuhët e huaja, varësisht prej kërkesave të grupit në fokus, mund të mbahen edhe në bazë të kërkesave specifike të grupit për mësimin e terminologjive të ndryshme profesionale për gjuhët përkatëse

Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci:

- Teknika Negocimi
- Zgjidhja e Konfliktëve
- Aqum Comunnitere e Bashkimit Evropian
- Institucionet e Bashkimit Evropian
- Komunikimi Masiv
- Shkathësi Diplomatike
- State Protocol

Mekatronikë dhe Teknologji të tjera

- Mekatronikë (Pneumatikë, Elektro-Pneumatikë, E-Teknika / Programmable Logic Controllers (PLC), Hidraulikë, Elektro-Hidraulikë, Sistemet e Kontrollit Hidraulik, Sensorët
- Design Assembly & Mirëmbajtja e Sistemeve Mekatronike
- CAx - Teknologjitë (CAD/CAM, CAQ, CAP dhe CA të tjera)
- CNC-Teknikat
- Robotikë
- Teknika të Punës/ Organizim i Punës
- Mbrojtja e Mjedisit

- Teknika të Sigurisë për mbrojtjen së punëtorëve
- Dokumentimi Teknik
- Saldimi
- Inovimi

Teknologji Informative

- CISCO
- IT Essencial
- CCNA Discovery 1.2.3.4
- CCNA Exploration 1.2.3.4
- ECDL
- Hardware
- Inxhiniering i Software (Gjuhët programuese dhe Bazat e të Dhënave)
- Rrjetizim
- Simulim i Kompjuterit
- Disenj Kompjuterik dhe Animacion
- Sisteme Aplikative të Ndërmarrjes
- Aplikime të Internetit
- Paketat CAD/CAM
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorë (CRM)
- Modelimi, Optimizimi dhe simulimi

Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

- Menaxhimi i Projekteve Konstruktuese
- Projektim me AUTO CAD, ARCHI CAD
- Materiale Konstruktuese dhe Kontroll Kualiteti
- Menaxhim Urban
- Certifikim për Kualitet
- Marketing në Arkitekturë

Trajnimet profesionale në disiplinat e lartcekura ofrohen në periudha të ndryshme, në bazë të kërkesës së individëve, institucioneve, kompanive dhe korporatave të ndryshme. Një grup profesionistësh vendorë dhe ndërkombëtarë, me përgatitje akademike superiore dhe përvojë të suksesshme, janë në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar një vistër të gjerë trajnimesh për një karrierë personale të avancuar dhe për sukses të padiskutueshëm të ndërmarrjes apo institucionit tuaj.

Vërejtje e rëndësishme: Ju lutemi, mos hezitoni të kontaktoni zyrтарin përgjegjës për Trajnime profesionale në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, përmes numrit të telefonit 038 541 400.

Top University Education for Top Students



- 12 vite Lider i Arsimit të Lartë
- I certifikuar sipas standardit ISO 9001 për cilësi
- Përfutjes nga Kosova i Programit Evropian ERASMUS MUNDUS
- Përfaqëson Kosovën në Organizata Evropiane dhe Botërore
- Kampion Evropian në Robotikë
- Kampusi i parë për Inovacione

Zgjedh më të mirin ...

... që të bëhesh më i miri!

Come to UBT and go everywhere...


Në bazë të Statutit dhe Vendimit të Rektorit nr.1754/45-12 të datës 08.07.2013 UBT shpall:


KONKURS


Për vitin akademik 2013/2014 në këto programe studimi:

- **MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI (BA, MA)**
 - Financa, Banka dhe Kontabilitet,
 - Marketing dhe Shitje,
 - Menaxhment dhe Ndërmarrësi
- **SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI (Bsc, MSc)**
 - Rrjeta dhe Telekomunikacion
 - Softuer dhe Sisteme Inxhinierie,
 - Baza e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit
 - Dizajni dhe Multimedia
 - Mekatronikë dhe Robotikë
- **MENAXHMENT I MEKATRONIKËS (BSc, MSc)** (Elektroteknika, Elektronika, Teknologjia e Informacionit, Prodhimtaria Industriale, Dizajni Industrial, Ndërmarrësi dhe Menaxhment)
- **ARKITEKTURË (BSc)** (I vetmi privat i akredituar në vend)
- **JURIDIK (LLB)** (Civile, Penale dhe Ndërkombëtare)
- **SISTEMET INFORMATIVE (BSc)** (Menaxhment, Biznes dhe Informatikë)
- **SHKENCAT POLITIKË (BSc)**
 - Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci
 - Integritme Evropiane
 - Administratë Publike
- **MEDIA DHE KOMUNIKIM (BSc)**
- **NDËRTIM DHE INXHINIERI E MJEDISIT ME INFRASTRUKTURË (BSc)** (I vetmi privat i akredituar në vend)

Përmes UBT-së ju mund të studioni dhe të përfitoni bursa studimi në Universitet partnerë si:

 Vienna University of Technology, Austri
Engineering Management (MSc)


 University of Warsaw, Poloni
International Relation (BA, MA)

 City University London, Angli
Computer Science and Engineering (BSc, MSc)

 HiG - Gjøvik University, Norvegji
Computer Science and Engineering (Mobility)

 CIFE - Centre International de Formation Europ, Francë
European Integration and Law (MA)

 Danube University Krems, Austri
Master in Business Administration (MBA)

 WIT (Waterford Institute of Technology), Irlandë
Master in Information Systems (MSc)

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

Diploma, dëftesat e notave, certifikata e lindjes, kopia e letërnjoftimit dhe dy fotografi 4X6

Gjuha e studimeve: Gjuha Shqipe dhe Gjuha Angleze

Mënyra e studimit:

UBT organizon ligjërata të rregullta gjatë ditës dhe gjatë fundjavës

Që sukseti juaj të jetë i garantuar, UBT ofron për secilin studentë:

- Orientim profesional, kurse përgatitore, praktika profesionale, vizita studimore dhe certifikime ndërkombëtare
- Nga një kompjuter gjatë studimeve dhe sistem online
- Praktika dhe Eksperimente në Laboratorët bashkëkohorë
- Trajtime: CISCO, Microsoft, AutoCad, ECDL, Projekt, etj.

Financat dhe pagesat:

- Çmimi i studimeve për një vit akademik është 1200 €, me mundësi pagese deri në 12 këste.

Për të gjithë nxënësit e dalluar UBT ofron zbritje 20-50%

UBT ofron zbritje deri në 30% edhe për këto kategori:

- Të punësuarit në Doganat e Kosovës
- Pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës
- Të punësuarit në Institucionet Publike të Kosovës
- Familjarët e dëshmorëve dhe veteranëve të luftës
- Studentët që vijnë nga e njëjta familje dhe si grup
- Studentët që paguajnë në fillim të vitit akademik

Unk është vetëm diplomë...



... është PRESTIGJ!

... është SUKSESI!

... është CILËSI! American European University Education

Lagjia Kalabria p.n., Prishtinë, Tel:038 541400 Mob:044 541400, Email:info@ubt-uni.net Koha e regjistrimit çdo ditë prej orës 09:00 deri në 17:30

Apliko online: www.ubt-uni.net/apliko ose në qendrat për Informim dhe Regjistrim në Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë, Podujevë, Gjilan dhe Rahovec